



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË
USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

**“AUDITIM FINANCIAR NË BASHKINË
KLOS”**

TIRANË, DHJETOR 2019



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË
USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

NR.	PERMBAJTJA	FAQE
I	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	04-14
I/c	OPINIONI I AUDITIMIT	14-18
II	HYRJA	19-23
III	PËRSHKRIMI AUDITIMIT	24-69
	<i>Informacioni i Përgjithshëm.</i>	24-25
IV	GJETJET DHE REKOMANDIMET	26-57
A/1/2	<i>Mbi vlerësimin e riskut.</i>	26-27
A/3	<i>Kontrolli i brendshëm</i>	28-31
B	<i>Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit</i>	32-45
C	<i>Vlerësimi i raportimit financiar, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi .</i>	46-55
D	<i>Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.</i>	56-57
	REKOMANDIME:	58-66



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

SHKURTIME.

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit.
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.
NA	Nëpunës Autorizues.
NZ	Nëpunës Zbatues.
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik.
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm.
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm.
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara.
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave.
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak.
ISSAI	Standartet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit.
ISA	Standartet Ndërkombëtare të Auditimit
IFAC	Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
ALUIZNI	Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave të Ndërtimeve Informale.
IT	Teknologjia e Informacionit.
NJA	Njësi Administrative.
SHA	Shoqëri Anonimë.
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë.
OE	Operator Ekonomik.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1.a. Në përputhje me objektin e auditimit, u auditua me zgjedhje mbi bazë materialiteti dhe risku gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe monitorimi i tyre nga auditi i brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit për të ardhurat dhe shpenzimet, mbajtja e kontabilitetit dhe hartimi i pasqyrave financiare, aplikimi i rregullave kontabël si dhe nëse transaksionet financiare janë në përputhje me kërkesat ligjore, rregullave të institucionit dhe parimeve për një qeverisje të mirë në përmbushje të objektivave të institucionit Bashkia Klos dhe ligjit nr. 139/15 dt. 17.12.15 “Për vetëqeverisjen vendore” si dhe zbatimi i procedurave të prokurimit publik dhe të kontratave të lidhura. Për këto u analizuan pyetësorët e vetëvlerësimit, akt akordimet me thesarin duke shkarkuar 65 transaksione financiare nga data bazë e thesarit, u krye analiza e posteve të bilancit dhe llogarive analitike me formatet shoqëruese të tyre duke prekur zonat e llogarive, 600 “paga”, 602 “shpenzime operative” dhe 230- 231 “investime, etj.

I.b. PËRMBLEDHJE E GJETJEVE KRYESORE.

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Referenca në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
1	Mbi zbatimin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Bashkinë Klos. Nga auditimi rezultoi se në Bashkinë Klos Rregullorja e Brendshme e Funkcionimit nuk është në koherencë të plotë me strukturën aktuale të Bashkisë; Nuk ka kod etik të veçante, por në rregulloren e brendshme të funksionimit, është përcaktuar në nenin 8, “Etika për punonjësit e Bashkisë Klos dhe kodi i veshjes”; Në Rregulloren e Funkcionimit nuk ka procedura mbi trajtimin e rasteve të shkeljeve apo thyerjes së disiplinës nga ana e stafit. Gjatë periudhës së auditimit nuk janë kryer vlerësime periodike të stafit, por vetëm vlerësime të stafit të ri pas periudhës së provës. Nuk ka plane trajnime të miratuar, pavarësisht se janë bërë trajnime kryesisht nga të tretë, për persona të caktuar, nuk ka manuale mbi procedurat për operacionet kryesore, por ato janë përshkruar në rregulloren e brendshme; Nuk ka rregulla të brendshme që garantojnë sigurinë e sistemit IT, veprime jo në përputhje me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ndryshuar, si aktet ligjore e nënligjore dalë në zbatim të tij	28-30 dhe aneks A	I mesëm	Nga ana e Bashkisë Klos të merren masa për: - përputhjen e rregullores së brendshme të funksionimit me strukturën organizative si dhe të përcaktohen procedura për trajtimin e rasteve të shkeljeve apo thyerjes së disiplinës nga ana e stafit; - hartimin e kodit etik; - hartimin e manualeve mbi procedurat për operacionet kryesore - kryerjen e vlerësimeve periodike të stafit; - përcaktimin e rregullave që të garantojnë sigurinë e sistemit IT
2	Në Bashkinë Klos është krijuar Njësia e auditimit të brendshëm publik, me një specialit, nga 3 që duhet të ketë. Nga mbikëqyrja e veprimtarisë së njësive Auditimi Publik në Bashkinë (AB) Klos, rezultoi se për periudhën objekt auditimi 2 vjet e 9 muaj respektivisht për vitet 2017, 2018 deri 30.09.2019, u konstatuan mangësitë e mëposhtme: <i>a. Organika e Njësive së AB është vetëm me 1 person, nga 3 që duhet të ketë, pra nuk garantohet kryerja e shërbimit të auditimit.</i>	30-31 dhe aneks A	I Lartë	Nga ana e Bashkisë Klos të merren masa për plotësimin e organikës dhe vënien në funksion të Njësive së Auditimit të Brendshëm. Në se nuk mundësohet plotësimi i organikës, me qëllim mos lënien jashtë kontrollit të Njësive Administrative, të negociohet me Bashkinë më të afërme, duke lidhur akt marrëveshje me Njësinë e Auditit të Brendshëm të kësaj Bashkie, bazuar në: <i>a. ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin</i>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË
USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Referenca në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>b. Nuk ka plane vjetore auditimi të miratuar nga titullari;</p> <p>c. Edhe një punonjës auditimi që është emëruar, në njësinë e auditit të brendshëm Bashkia Klos, ai, nuk plotëson kushtet e përcaktuara nga ligji nr.114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 11 “Punësimi i audituesit të brendshëm” shkronja b, c dhe ç; pasi drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm nuk është i certifikuar si “Auditues i brendshëm” dhe nuk ka përvojë pune 5 vjet si auditues i brendshëm ose i jashtëm.</p> <p>d. Nga 12 auditime për vitin 2017, ka realizuar 4 angazhime, kurse për vitin 2018 dhe 9 mujorin 2019 nuk ka realizuar asnjë auditim (angazhime).</p> <p>e. Nuk është hartuar manuali specifik i AB;</p> <p>f. Nuk është hartuar Karta e Auditit të Brendshëm, kërkesë e nenit nr.12, pika c, neni 14, pika b dhe neni 24, pika c të ligjit nr.114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e brendshëm në Sektorin publik” dhe shkronja a, neni 64 të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen vendore”;</p> <p>g. Mungon dokumentacioni i dosjeve të auditimit sipas kërkesave të Manualit të Auditit të Brendshëm, Kapitulli VI, “Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese” edhe ai pak dokumentacion i hartuar për auditimet e kryera është i pa protokolluar.</p> <p>Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me ligjin nr.114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e brendshëm në Sektorin publik”, Manualit të Auditit të Brendshëm, miratuar me urdhrin e Ministrit Financave nr. 100, datë 25.10.2016 “Për miratimi e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, VKM nr.83, datë 03.02.2016, “Për miratimin e kriterëve për ngritjen e njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik” si dhe detyrat e përcaktuara në rregulloren e brendshme të funksionit, të Bashkisë Klos neni 26, “Detyrat kryesore të Përgjegjës të Sektorit”</p>			<p>publik në nenin”, neni 10 shkronja c) ku parashikohet se: në rastet kur asnjë nga opsionet e parashikuara në shkronjat “a” dhe “b”, të këtij neni, nuk është i mundur të realizohet, shërbimi i auditimit të brendshëm kryhet nga njësia e auditimit të brendshëm e një njësie tjetër publike, në bazë të një marrëveshjeje ndërmjet titullarëve të njësive publike përkatëse. Marrëveshja miratohet paraprakisht nga Ministri i Financave;</p> <p><u>b. VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, pika 6 ku parashikohet se: 6. Njësitë publike, të cilat nuk plotësojnë kriteret për krijimin e njësive të auditimit sipas pikës 1, të këtij vendimi, dhe nuk kanë varësi nga ndonjë organ epror, e sigurojnë shërbimin e auditimit të brendshëm, nëpërmjet: a) marrëveshjes midis titullarëve të njësive publike përkatëse, të cilat kanë njësi të auditimit të brendshëm dhe kapacitetet e nevojshme për të marrë përsipër kryerjen e shërbimit të auditimit të brendshëm. Kjo marrëveshje miratohet paraprakisht nga ministri i Financave;</u></p>
3	<p>Buxheti për vitin 2017 nuk është përgatitur dhe miratuar brenda datës 25 dhjetor të vitit paraardhës. Buxhetet nuk janë paraqitur për miratim brenda muajit nëntor të vitit buxhetor nga kryetari i njësive të qeverisjes vendore në Këshillin Bashkiak. Nuk është e qartë nëse buxhetet janë publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike brenda 15 ditëve nga miratimi i tyre. Kryetari i njësive të qeverisjes vendore nuk ka bërë analizë të plotë të zbatimit të buxhetit brenda muajit</p>	35 – 37 dhe aneks B	I Lartë	<p>Për vitet në vazhdim, kryetari i Bashkisë Klos të marrë masa për:</p> <p>- diskutimin e buxhetit të vitit pasardhës në këshillin bashkiak brenda muajit nëntor të vitit buxhetor dhe për miratimin përfundimtar të tij jo më vonë se data 25 dhjetor. Këto vendime të publikohen rregullisht brenda 15 ditëve në buletin e Njoftimeve Publike dhe zbatimi i buxhetit të analizohet brenda muajit</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË
USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Referenca në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>qershor të çdo viti. Përsa i përket pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve të tyre rezultoi se ka diferenca të dukshme midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit.</p> <p>Në buxhetet e çdo viti janë planifikuar shpenzimet në vazhdim, por jo në të gjitha rastet është zbatuar radha e financimit.</p> <p>Për rastet e investimeve nga të ardhurat, një pjesë e prokurimeve janë bërë pa pasur fonde në dispozicion, vetëm në bazë të planifikimit.</p> <p>Përgjithësisht, pagesat e faturave janë bërë gjatë gjithë vitit, por ka pasur raste për investimet e planifikuara për t'u bërë nga të ardhurat, që faturat të paguhen me vonesë, për shkak të mosrealizimit të të ardhurave.</p> <p><i>Sa më sipër bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në R.SH”, ndryshuar me ligjin nr. 114/2012, datë 07.12.2012 dhe ligjin nr. 57/2016, datë 2.6.2016), ligjin nr. 130/2016, datë 17.12.2016 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2017”, dhe ligjin nr. 109/2017, datë 30.11.2017 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2018”, me ndryshimet</i></p>			<p>qershor të çdo viti, në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit.</p> <p>- Bashkia Klos të marrë masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve. Të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin e buxheteve paraardhës duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse.</p>
4	<p>Nga auditimi në Bashkinë Klos, rezultoi se nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik nuk është ruajtur plotësisht radha e financimit për procedurat e raportuara si të prapambetura.</p> <p>Në lidhje me faturat e palikuiduara: për vitin 2017 nga 14,814,020 lekë të planifikuara janë shpenzuar 14,499,884 lekë dhe për vitin 2018 nga 39,655,776 lekë të planifikuara janë shpenzuar 38,667,121 lekë.</p> <p>Shpenzimet operative (602+603+604+606): për vitin 2017 nga 5,277,961 lekë të planifikuara janë shpenzuar 4,963,825 lekë dhe për vitin 2018 nga 7,754,569 lekë të planifikuara janë shpenzuar 7,740,569 lekë.</p> <p>Faturat e pa likuiduara për investime dhe shpenzime të ndryshme, në datën 31.12.2018 paraqiten në vlerën 82,085,867 lekë, krahasuar me gjendjen më 31.12.2017 janë ulur në vlerën 38,072,341 lekë ose krahasuar me gjendjen më 31.12.2016 janë rritur në vlerën 4,145,541 lekë.</p> <p>Nga administrata e Bashkisë Klos nuk janë zhvilluar procedura të mjaftueshme për planifikimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura</p>	37 – 38 dhe aneks B	I Lartë	<p>Bashkia Klos (Sektori i Financës), bazuar në UMF nr. 2, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” dhe UMF nr. 1, datë 17.01.2019 “Për buxhetin e vitit 2019”, pikat 106-110, “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, pikat 116-11, 7 “Raportimi i detyrimeve të prapambetura në njësitë e qeverisjes vendore”, të paraqesë në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, të hartojë një grafik duke zbatuar radhën e pagesave sipas kohës së krijimit të tyre për vlerën 82,085,867 lekë. Të respektojë radhën e financimit për procedurat e raportuara si të prapambetura dhe të zhvillojë procedura të mjaftueshme për planifikimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.</p>
5	<p>Në Bashkinë Klos ka një sasi të madhe debitorësh nga biznesi, (pothuajse i njëjti numër me bizneset aktive, pasi një pjesë e bizneseve debitorë nuk janë me status aktiv).</p> <p>Vlera totale e debisë për taksën e tokës është 5,477,706 lekë (nga këto janë kontabilizuar 2,976,662 lekë), pjesa tjetër është e pa kontabilizuar pasi këtu është përfshirë edhe vlera</p>		I Lartë	<p>Bashkia Klos, të verifikojë gjendjen në kontabilitet dhe mënyrën e kontabilizimit të detyrimit në ngarkim të subjekteve debitorë për taksat dhe tarifatat vendore dhe familjeve debitorë për taksën e tokës dhe të ndërtesës, të kontabilizojë pjesën e pa kontabilizuar të këtyre detyrimeve dhe të kërkojë sipas ligjit, arkëtimin e vlerave</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË
USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Referenca në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>2,471,044 debi gjendje 30.09.2019 për detyrimet e vitit 2019.</p> <p>Vlera totale e debisë për taksat e tarifatat të familjarëve është 13,766,523 lekë (nga këto janë kontabilizuar 9,303,640 lekë), pjesa tjetër është e pa kontabilizuar pasi këtu është përfshirë edhe vlera 4,462,883 debi gjendje 30.09.2019 për detyrimet e vitit 2019).</p> <p>Vlera totale e debisë për bizneset (detyrim kamate) është 23,861,427 lekë.</p> <p>Detyrimi prej 37,627,950 lekë (taksat e tarifatat të familjarëve 13,766,523 lekë + debia për bizneset (detyrim kamate) 23,861,427 lekë) përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Klos, kontabilizuar 24,693,324 lekë dhe pa kontabilizuar shuma pa kontabilizuar shuma 12,934,626 lekë.</p> <p>Detyrimi prej 4,300,000 lekë nga subjektet që tregtojnë karburante përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Klos.</p> <p>Detyrimi prej 615,773 lekë nga taksa për ndikimin në infrastrukturë nga objektet e legalizuara, përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Klos.</p> <p>Nga Sektori i të Ardhurave të Bashkisë Klos, nuk janë marrë masa për arkëtimin e detyrimeve debitorë, duke ribërë njoftim vlerësimet tatimore vendore për të gjithë subjektet debitorë. Nuk janë zbatuar masa shtrënguese, me qëllim arkëtimin e detyrimeve tatimore.</p> <p>Sektori i të Ardhurave Vendore nuk ka dërguar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, asnjë kërkesë për të vendosur Barrë Sigurie mbi titujt e pronësisë për mjetet dhe pasuritë e paluajtshme, sipas nenit 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.</p>	38- 41 dhe aneks B		<p>debitorë nga personat përkatës juridikë ose fizikë dhe familjarët, duke zbatuar sipas rastit edhe masat shtrënguese në zbatim të Kreut XI “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar” të Ligjit nr. 9920, dt. 19.5.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar për:</p> <p>Detyrimet për taksën e tokës në vlerën 5,477,706 lekë.</p> <p>Detyrimet në vlerën 13,766,523 lekë për taksat dhe tarifatat të familjarëve.</p> <p>Vlera totale e debisë për bizneset (detyrim kamatë) është 23,861,427 lekë, (2011-2016 (vlera 11,697,917 lekë e kontabilizuar pa kamatëvonesën 1,895,063 lekë) + 2017 (vlera 2,124,448 lekë e kontabilizuar pa kamatëvonesën 344,161 lekë) + 2018 (vlera 1,567,319 lekë e kontabilizuar pa kamatëvonesën 253,906 lekë) + 2019 (vlera 2,493,129 lekë e pa kontabilizuar, pasi detyrimi e ka afatin deri me datë 31.12.2019). Në total kontabilizuar vitet 2011-2018 me vlerë në 15,389,684 lekë, dhe pa kontabilizuar shuma 2019 + kamatëvonesat 2011-2018 në vlerën 8,471,743 lekë, përkatësisht kamatëvonesat në vlerën 2,493,129 lekë dhe viti 2019 me vlerë në 5,978,614 lekë.</p> <p>Detyrimi prej 615,773 lekë nga taksa për ndikimin në infrastrukturë nga objektet e legalizuara, përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Klos.</p>
6	<p>Ka mangësi në kryerjen e akt akordimeve me institucionet përkatëse dhe diferencë të madhe në të ardhurat e planifikuara nga agjentët tatimorë me realizimin, kryesisht me ish ZVRPP-në për taksën e kalimit të pronësisë dhe DSHTRR-në për taksën vjetore të mjeteve të përdorura.</p> <p>Bashkia Klos nuk ka krijuar baza të plota të dhënash për detyrimet që vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, në bazë të të cilave të bëjë akt-rakordimet.</p> <p>Mungesë e marrëdhënieve dhe korrespondencës me institucionet e tjera, shtetërore apo private, me qëllim evidentimin dhe mbledhjen e të ardhurave tatimore dhe tarifore.</p>	41 – 42 dhe aneks B	I Lartë	<p>Bashkia Klos, të marrë masa për evidentimin e diferencave të pa mbledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për gjobitjen e këtyre agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura, sipas përcaktimeve në nenin 117 të Ligjit 9920, dt. 19.5.2008, “Për Procedurat Tatimore”, ku parashikohet se “Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave”, ku përcaktohet se: “Agjenti i mbajtjes së tatimit në burim, agjenti i taksave apo tarifave, që nuk arrin të mbajë, të llogarisë, të raportojë dhe të transferojë në Buxhetin e Shtetit tatimin në burim apo tatimet, taksat dhe</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË
USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Referenca në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
				<i>tarifat e mbledhura, apo i shmangjet mbledhjes së tyre, detyrohet të paguajë gjobë të barabartë me 50 për qind të shumës së plotë të tatimit, taksës apo tarifës së pa mbledhura apo të shmangur.” Të marrë masa për të krijuar bazat e të dhënave për subjektet, tarifat apo taksat e të cilave mblidhen nëpërmjet agjentëve tatimorë, të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministri i Financave.</i>
7	<p>Për asetet në pronësi të bashkisë, nga auditimi u konstatua se ka mangësi në lidhje me përditësimin e sipërfaqes faktike në dispozicion dhe asaj të regjistruar në ZVRPP (nëse ka) apo në listat e transferimit të pasurive nga KM. Kjo nuk është pasqyruar në inventarin e pasurive të paluajtshme dhe i ka hapur rrugë informalitetit. Gjithashtu, deri në periudhën objekt auditimi, shumë pak nga objektet e dhëna me qira figurojnë të regjistruara në ZVRPP, pra në pak raste Bashkia Klos disponon Tituj (Certifikata) Pronësie për objektet apo tokat e kontraktuara.</p> <p>Nga informacioni i vënë në dispozicion, u konstatua se nga kompanitë të cilat bëjnë investime strategjike në territorin e Bashkisë Klos, nuk është bërë asnjë procedurë për kontraktimin e sipërfaqeve në përdorim të tyre. Konkretisht, subjekti “G...”, i cili ndërton me PPP “Rrugën e Arbrit”, ka ngritur disa kantiere dhe kapanone në territorin e Bashkisë Klos, përdor territorin e Bashkisë Klos për depozitimin e mbetjeve dhe inerteve të nxjerra gjatë gërmimeve, përdor mineralin e nxjerrë nga territori i Bashkisë Klos, përfshirë mineralin e nxjerrë nga tunelet pa pasur një kontratë, marrëveshje apo autorizim me Bashkinë Klos, sipas ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 21 “Shfrytëzimi i grupit të mineraleve ndërtimore” pika 2-a), në të cilën parashikohet se: “2. Përrjashtimisht, shfrytëzimi i grupit të mineraleve ndërtimore është i lirë, në rastet kur: a) autoritetet vendore dhe qendrore ose persona të tjerë të autorizuar prej tyre, të përfshira në ndërtimin e rrugëve publike ose në ndërtime të tjera publike, përdorin mbeturinat nga gërmimet e nevojshme;”.</p> <p>Përveç sa më sipër, ky subjekt duhet të lidhë edhe marrëveshjet përkatëse për shpyllëzimin dhe pyllëzimin e sipërfaqeve të cilat do të përdoren për ndërtimin e rrugës, etj.</p> <p>Ky subjekt nuk është pajisur me NUIS sekondar për aktivitetin që ushtron në territorin e Bashkisë</p>	42- 44 dhe aneks B	I Lartë	<p>Bashkia Klos të marrë masa për të verifikuar situatën në terren me subjektet që ushtrojnë veprimtari ndërtimore/minerare, etj. në territorin e saj, t’i autorizojë ose të lidhë kontrata apo aktmarrëveshje për t’i lejuar përdorimin sipas ligjit të materialeve/mineraleve të përfituara nga gërmimet ose në të kundërt të fillojë procedurat për vjeljen e rentës minerare.</p> <p>Bashkia Klos të lidhë marrëveshje/kontrata me kompanitë ndërtuese të rrugëve, si për vendet ku këto kompani depozitojnë dherat teknologjike, ashtu edhe për sipërfaqet që do të shpyllëzohen apo përdoren për ndërtimin e kapanoneve, kantierëve, etj.</p> <p>Bashkia Klos, të kontabilizojë detyrimet dhe kamatëvonesat e subjekteve ndërtues që nuk kanë paguar taksat dhe tarifat vendore, duke filluar që nga momenti i fillimit të veprimtarisë së tyre në territorin e saj dhe të ndjekë në vazhdimësi pagesat e detyrimeve vendore nga këto subjekte me veprimtari të përkohshme në territorin e saj.</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË
USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Referenca në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	Klos dhe nuk paguan taksat dhe tarifat vendore.			
8	<p>Gjatë auditimit të tarifave vendore për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, u konstatua se ka mangësi në plotësimin e të dhënave të këtyre subjekteve në përgjithësi dhe debitorëve në veçanti, si p.sh., në krijimin e një regjistri të posaçëm për këto lloj subjektësh, në evidentimin e subjekteve që e ushtrojnë këtë lloj aktiviteti dhe në mbledhjen e detyrimeve specifike për këto kategori biznesi. Nga auditimi i kësaj kategorie të bizneseve, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua se nga ish-komunat dhe ish-bashkia, si para konsolidimit, ashtu edhe pas konsolidimit, vazhdimisht është aplikuar në mënyrë të gabuar tarifa për pajisjen me leje tregtimi për karburantet. Konkretisht, në VKM-në Nr. 344, datë 19.04.2017, e cila ka ndryshuar VKM-në Nr. 970, datë 2.12.2015, parashikohet se: “9. <i>Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3,000,000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1,000,000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera.</i>”... “10. <i>Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, është 500,000 (pesëqind mijë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 100,000 (njëqind mijë) lekë për bashkitë e tjera.</i>”. Sipas këtyre detyrimeve ligjore, të gjitha subjekteve që ju ka mbaruar afati 5 vjeçar i autorizimit pas datës të hyrjes në fuqi të VKM-së nr. 970, datë 2.12.2015, për rinovimin e licencës duhet të paguajnë si më sipër.</p> <p>Në shumicën e rasteve tarifa e pajisjes me autorizim për tregtimin e hidrokarbureve është llogaritur gabim. Kjo përbën të ardhur të munguar për Buxhetin e Bashkisë Klos, në vlerën 4,300,000 lekë.</p>	44 – 45 dhe aneks B	I Lartë	<p>Bashkia Klos të marrë masa për të kontabilizuar detyrimin dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej 4,300,000 lekë, (sipas detajimeve në anekset bashkëlidhur), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit ndaj debitorëve. Gjithashtu, të verifikojë nëse ka subjekte të tjera të cilat në QKB figurojnë aktivë dhe me objekt aktiviteti tregtinë e karburanteve apo lëndëve djegëse për popullatën të cilat zhvillojnë këtë lloj aktiviteti dhe të licencohen apo të pezullohen, sipas rastit.</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË
USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Referenca në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
9	<p>Aktivitet të cilat janë detajuar me regjistra kontabël (llogaria 210 “Toka, troje e terrene”, llogaria 211 “Pyje, Plantacione dhe Kullota”) nuk përmbushin kriteret e paraqitjes së formatit si dhe nuk janë azhurnuar pas bashkimit të njësive administrative duke dhënë një pamje jo të plotë për këto regjistra. Sektori i financës Bashkia Klos për asnjë periudhë raportuese objekt auditimi (2017-2018), nuk ka kërkuar dhe bërë rivlerësim të pasurisë, asetëve dhe aktiveve të transferuara me VKM në kuadër të reformës territoriale me çmimin referues, si dhe nuk janë pasqyruar në aktivet e qëndrueshme të trupëzuara në pasqyrat financiare për secilën periudhë raportuese konkretisht:</p> <p>-llog.(210)“Toka, troje, terrene” vlera kontabël 999,520 lekë e pa ndryshuar.</p> <p>-llog.(211)“Pyje, kullota, plantacione” vlera kontabël 0 lekë e pa ndryshuar.</p> <p>Sektori i Financës dhe kontabilitetit për këto asetet nuk disponon regjistra, kartela llogarie dhe dokumentet kontabël me të dhëna të domosdoshme mbi objektet me qëllim të evidentohen të dhënat e nevojshme si (viti krijimit të asetit, amortizimi në vite, planimetria dhe projekti objektit ndërtimor, etj.).</p>	46 – 47 dhe aneks C	I Lartë	<p>Nga ana e Bashkisë Klos të merren masa për të azhurnuar regjistrat kontabël me informacion të plotë pas bashkimit me njësitet administrative duke plotësuar kërkesat e formatit të paraqitjes së tyre, të përpilohet lista e aktiveve të identifikuara për vlerësim dhe inventarizim. Titullari i njësisë publike Bashkia Klos të ngrejë një grup pune me specialist përkatës, për evidentimin e asetëve dhe pasurisë të kaluara me VKM në pronësi të Bashkisë, ndërsa nga Sektori i Financës, të merren masa me qëllim të saktësohet gjendja fizike dhe kontabël e llog.(210); llog.(211) me qëllim pajisjen me dokumentet e nevojshme tekniko-ligjore për të regjistruar secilin objekt në ZRPP në pronësi të Bashkisë Klos, si dhe pasqyrimin me dokumente ligjore të gjendjes së këtyre asetëve.</p>
10	<p>Nga auditimi konstatohet se: <u>1.Për investimin me objekt “Ndërtim i Bypass-it të Oytetit të Klosit”</u> kontrata është lidhur në vitin 2017 me vlerën e plotë prej 117,389,925 lekë, edhe pse akti i marrjes në dorëzim është në datën 08.08.2018 nga vlera totale e investimit prej 117,389,925 lekë, vlera prej 71,225,083 lekë është pasqyruar në bilancin e vitit 2017, ndërsa vlera prej 47,104,802 lekë është paraqitur në bilancin e vitit 2018. Nga ana e Sektorit të Financës së Bashkisë Klos e gjithë vlera e investimit prej 117,389,925 lekë duhet të ishte paraqitur në bilancin e vitit 2018, pra në momentin e marrjes në dorëzim të veprës.</p> <p>Për vlerën 71,225,083 lekë, e cila nuk është pasqyruar në bilancin e vitit 2018, ndërkohë që i gjithë investimi ka përfunduar në vitin 2018, transaksionet dhe ngjarjet nuk janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël. <u>2.Për investimin me objekt “Ndërtim i Kanalit Suc”</u> kontrata është lidhur në vitin 2017 me vlerën e plotë prej 1,391,016 lekë, edhe pse akti i marrjes në dorëzim është në vitin 2018 nga vlera totale e investimit prej 1,391,016 lekë, vlera prej 500,000 lekë është pasqyruar në bilancin e vitit 2017, ndërsa vlera prej 891,016 lekë është paraqitur në bilancin e vitit 2018. Nga ana e Sektorit të Financës së Bashkisë Klos e gjithë vlera e investimit prej 1,391,016 lekë duhet të ishte paraqitur në bilancin e vitit 2018, pra në momentin e marrjes në dorëzim të veprës.</p> <p>Për vlerën 500,000 lekë, e cila nuk është pasqyruar</p>	47 – 49 dhe aneks C	I lartë	<p>Sektori i financës në të gjitha regjistrimet kontabël, të veprojë sipas parimit të konstatimit: të gjitha shpenzimet të pasqyrohen në kontabilitet dhe në pasqyrat financiare, atëherë kur ato ndodhin dhe jo kur kryhet pagesa. Raportimi i tyre në pasqyrat financiare të bëhet në atë periudhë kontabël së cilës i përkasin shpenzimet. Nga titullari të merren masa për regjistrimin e asetëve të llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në ZRPP dhe kontabilitet.</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË
USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Referenca në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>në bilancin e vitit 2018, ndërkohë që i gjithë investimi ka përfunduar në vitin 2018, transaksionet dhe ngjarjet nuk janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël. <u>3.Për investimin me objekt “Ndërtim i aksit Unjate-Mishter”</u> kontrata është lidhur në vitin 2017 me vlerën e plotë prej 2,153,631 lekë, edhe pse akti i marrjes në dorëzim është në vitin 2018 nga vlera totale e investimit prej 2,153,631 lekë, vlera prej 508,399 lekë është pasqyruar në bilancin e vitit 2017, ndërsa vlera prej 1,645,232 lekë është paraqitur në bilancin e vitit 2018. Nga ana e Sektorit të Financës së Bashkisë Klos e gjithë vlera e investimit prej 2,153,631 lekë duhet të ishte paraqitur në bilancin e vitit 2018, pra në momentin e marrjes në dorëzim të veprës.</p> <p>Për vlerën 508,399 lekë, e cila nuk është pasqyruar në bilancin e vitit 2018, ndërkohë që i gjithë investimi ka përfunduar në vitin 2018, transaksionet dhe ngjarjet nuk janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël.</p>			
11	<p>Për aktivitetin e vitit 2018, konstatohet se totali i faturave të pa likuiduara në fund të vitit 2018 në Llog (401-408) “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, paraqitet në vlerën 16,936,547 lekë ndërsa llog (467) “Kreditorë të ndryshëm”, paraqitet në vlerën 65,149,320 lekë. Arsyeja e mos likuidimit të këtyre faturave është nga mos realizimi i të ardhurave, mungesa e lëvrimin të fondeve dhe bllokimit të fondeve nga Ministria e Financave në fund të periudhës ushtrimore. Në testet e kryera bazuar tek të dhënat e sistemit “SIFQ” mbi faturat e likuiduara në periudhën Janar – Gusht 2019, për llogari të vitit 2018 dhe përpara, u konstatua se:- <u>Urdhër shpenzimi me nr.459 datë 15.04.2019 me objekt “Shpenzime për konstruksione të rrugëve”</u> me OE fitues “C...” është likuiduar me vlerën prej 4,450,025 lekë, rezulton se kontrata me nr.2560 datë 04.10.2018 është lidhur gjatë vitit 2018 dhe fatura tatimore ka nr.499 dhe paraqet datën 31.10.2018. Pra vlera prej 4,450,025 lekë paraqet një detyrim të lindur gjatë vitit 2018 dhe duhet të ishte e paraqitur në pasivin e bilancit të vitit 2018 në llog.467 “Kreditorë të ndryshëm”, gjë e cila nuk rezulton të jetë e përfshirë në analitikun e paraqitur nga Bashkia Klos. <u>-Urdhër shpenzimi me nr.208 datë 21.02.2019 me objekt “Skicka kadastrale për regjistrim pasurie (plan rievimi)”</u> me OE fitues “D...” është likuiduar me vlerën prej 38,000 lekë, rezulton se kontrata me nr.260 datë 11.09.2018 është lidhur gjatë vitit 2018 dhe fatura tatimore ka nr.260 dhe paraqet datën 08.10.2018. Pra vlera prej 38,000 lekë paraqet një detyrim të lindur gjatë vitit 2018 dhe duhet të ishte e paraqitur në pasivin e bilancit të vitit 2018 në llog.467 “Kreditorë të ndryshëm”, gjë e cila nuk</p>	49 – 50 dhe aneks C	I Lartë	<p>Sektori i Financës të paraqesë një material ku të rakordojë me sistemin SIFQ gjendjen e faturave të pa likuiduara në vlerën 69,637,345 lekë, duke ndjekur radhën e pagesave. Gjithashtu, të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave për likuidimin e faturave jashtë kontabilitetit, dhe për çdo rast faturat e pa likuiduara në fund të vitit ushtrimor të bëhet kontabilizimi i tyre, duke i paraqitur si detyrime në fund të periudhës ushtrimore.</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË
USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Referenca në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>rezulton të jetë e përfshirë në analitikun e paraqitur nga Bashkia Klos.Llog.467 “Kreditorë të ndryshëm” të Bilancit Kontabël në vitin 2018 të vlerës së detyrimeve të prapambetura të cilat duhet të jenë me vlerë kontabël 69,637,345 lekë dhe jo 65,149,320 lekë. Kjo llogari duhet të rakordohet me llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” me të njëjtën vlerë prej 69,637,345 lekë.</p> <p>Kjo procedurë mos pasqyrimi në Llog.467 “Kreditorë të ndryshëm” të Bilancit Kontabël të vlerës së detyrimeve të prapambetura të cilat janë me vlerë kontabël 69,637,345 lekë është në kundërshtim me nenin nr.3.3 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.8 datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore”. Mangësitë e mësipërme (mos regjistrim i faturave kreditore), në fund të periudhës ushtrimore si detyrime që Bashkia Klos ka ndaj subjekteve të ndryshme, bën që pasqyrat financiare të mos paraqesin realitetin e tyre.</p>			
12	<p>Nga auditimi u konstatua se Teprica e Granteve kapitale të brendshme mbeten me tepricë në fund të periudhave ushtrimore vetëm në rastet kur këto grante janë burim për investimet në proces të institucioneve (të papërfunduara ose të pa marra në dorëzim). Në aktiv të bilancit këto janë investime në proces në grupin e llogarive 23. Këto mbyllen (kapitalizohen) me fondet bazë në kohën kur investimi është përfunduar dhe marrë në dorëzim. Nga ana e Bashkisë Klos vlera 1,817,640 lekë bëhet e ditur se paraqesin investime të përfunduara e cila bie në kundërshtim me pikën 1.1.2 Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.8 datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore” ku thuhet qartë që duhet të ishin kapitalizuar me fondet bazë kur investimi është marrë në dorëzim. Pra llogaria 105 “Teprica e Granteve kapitale të brendshme” në këtë rast duhet të ishte në vlerën 0 lekë duke mos patur tepricë kreditore në fund të vitit.</p>	50 – 51 dhe aneks C	I mesëm	Nga Sektorit i Financës të Bashkisë Klos të merren masa për të bërë sistemimin në kontabilitet të investime të përfunduara në vlerën 1,817,640 lekë duke i debituar te llogaritë e grupit 23 (Investime) të aktiveve afatgjata dhe duke kredituar llog.105 “ <i>Teprica e Granteve kapitale të brendshme</i> ”.
13	<p>Nga auditimi u konstatua se nga vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare janë të ndryshme nga vlerat e paraqitura në raportet e monitorimit “<i>Shpenzimet korrente</i>” sipas bilancit paraqiten në vlerën 399,909lekë/000 kurse sipas raportit të monitorimit vlera e tyre është 400,317 lekë/000 me diferencë -408 lekë/000. Llog. 600 “<i>Paga e shpërblime të tjera personeli</i>” në formatin nr. 3/1 “Shpenzime të ushtrimit” paraqitet në vlerën 99,102 lekë kurse në raportin e monitorimit vlera e kësaj llogarie është 110,514 lekë/000 me një diferencë prej -1,412 lekë/000. Llog. 601 “<i>Kontribute Sigurime Shoqërore e shëndetësore</i>”</p>	51 – 53 dhe aneks C	I mesëm	Nga ana e Sektorit të Financës të Bashkisë Klos të merren masa për të bërë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË
USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Referenca në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>në formatin nr. 3/1 “Shpenzime të ushtrimit” paraqitet në vlerën 17,907 lekë/000 kurse në raportin e monitorimit 2018 vlera e kësaj llogarie është 17,867 lekë/000 me një diferencë prej 40 lekë/000. Llog. 602 “Mallra dhe shërbime të tjera” në formatin nr. 3/1 “Shpenzime të ushtrimit” paraqitet në vlerën 55,265 lekë/000 kurse në raportin e monitorimit 2018 vlera e kësaj llogarie është 65,400 lekë/000 më pak prej -10,135 lekë/000. Raportet e monitorimit të shpenzimeve për vitin 2018, që janë paraqitur në Ministrinë e Financave, ndër të tjera edhe për programin “Planifikim, menaxhim, administrim” të cilat nuk janë të plotësuar me një informacionin më të plotë me shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e PBA, buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel programi dhe artikulli, lidhur me ndryshimet e planit të produkteve, si në sasi dhe në vlerë në përputhje me Udhëzimet e Ministrit të Financave për zbatimin e buxhetit të shtetit. Mungojnë argumentet e plota në lidhje me mosrealizimin e produkteve dhe masat që parashikohen në të ardhmen për realizimin e tyre. Performanca e produkteve “Planifikim, menaxhim, administrim” nuk është e paraqitur e lidhur me realizimin e objektivave dhe politikës së programit ku të shpjegohej cilat ishin objektivat sipas PBA, politikat e çdo programi si dhe sa janë realizuar këto objektiva. -Të dhënat faktike të raportuara nga Bashkia Klos nuk janë në përputhje me shpenzimet e ushtrimit të paraqitura në formatin nr. 4 “Shpenzimet e ushtrimit”.</p>			<p>rakordimin dhe unifikimin e vlerave të paraqitura në pasqyrat financiare me vlerat e paraqitura në raportin e monitorimit të shpenzimeve. Raporti i Monitorimit për zbatimin e buxhetit, të përmbajë një informacion të plotë me shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e PBA, e buxhetit, nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel programi dhe artikulli, lidhur me ndryshimet e planit të produkteve, si në sasi dhe në vlerë.</p>
14	<p>Mos rakordimin e gjendjes fizike me gjendjen kontabël të inventarit të magazinave për 9/mujorin 2019. Në Bashkinë Klos, nga auditimi <i>i aktiveve afatshkurtra dhe aktiveve afatgjata, llogaritë:</i> Llogaria 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione” Llogaria 213 “Rrugë, rrjete dhe vepra ujore” Llogaria 31 “Materiale” rezultoi se për 9 mujorin 2019, janë zhvilluar 9 blerje me vlerë të vogël apo të lartë, të cilat janë artikuj ndërtimi, që do të vihen në objekt nga ana e vetë Bashkisë (me punonjësit e Bashkisë). Për Aktivet sa më sipër, të bëra hyrje janë hartuar akt marrjet në dorëzim nga komisionet përkatëse të marrjes në dorëzim, të ngritura me urdhër të Titullarit të Bashkisë. Janë bërë hyrje në magazinë materiale ndërtimi në vlerën 13,460,245 lekë dhe janë bërë dalje materiale në vlerën 2,275,287 lekë. Për periudhën 9 mujori 2019, gjendja e kartelave të magazinës për to nuk rakordon me gjendjen fizike të materialeve të bëra hyrje, në shumën 11,184,958 lekë. Gjithashtu për këtë mos rakordim u konstatua se vlera prej 10,427,467 lekë është bërë hyrje, nuk</p>	53 – 54 dhe aneks C/1	I Lartë	<p>Nga ana Bashkisë Klos të merren masa për ngritjen e një grupi pune, të përbërë nga Drejtorja e Urbanistikës, Drejtorja e Shërbimeve, Drejtorja e Zhvillimit Ekonomik, Sektori i Auditit të Brendshëm, me qëllim të verifikimit të materialeve të vëna në objekte (të cilësuarat nëpër akt konstatimet përkatëse), rakordimit të tyre nëpërmjet hartimit të situacioneve, deri në kryerjen e veprimeve me magazinën dhe kontabilitetin.</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË
USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Referenca në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>është gjendje në magazinë, nuk është bërë dalje dhe nuk është likuiduar nga Bashkia Klos.</p> <p>Ndërsa shuma prej 2,665,812 lekë, është bërë hyrje në magazinë, nuk është bërë dalje, nuk është gjendje fizike dhe është likuiduar.</p> <p>Në përdorimin e këtyre materialeve nuk ka urdhër dorëzimi, fletëkërkesa, plan shpërndarje, nuk ka fletë dalje provizore, nuk ka preventiva dhe situacione për punën e kryer. Gjithashtu nisur nga fakti se këto janë materiale ndërtimi, të cilat nuk mund të magazinohen, nuk janë bërë dalje direkt sipas objekteve (pa kaluar në magazinë).</p> <p>Në lidhje me këto materiale nga auditimi rezultoi se ekzistojnë akt konstatime të mbajtura nga Sektori i Shërbimeve, në NJA Suç, Gurrë, Xibër dhe për qytetin Klos.</p> <p>Këto konfirmojnë tërheqjen përkatëse nga magazina dhe vënien në objekt të tyre. Autorizimet janë firmosur nga personi i autorizuar dhe nga përfaqësues të Sektorit të Shërbimeve, për:</p> <p>NJA Suç në 21 raste NJA Gurrë në 26 raste Klos në 22 raste NJA Xibër në 31 raste</p>			
15	<p>Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve në mënyrë të përmbledhur zbatimi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:</p> <p>a . Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 14 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 14 masa, nga të pranuarat janë zbatuar 6 masa dhe janë në proces zbatimi 6 masa organizative dhe ka 2 masa organizative të pa zbatuara.</p> <p>b. Për shpërblim dëmi janë rekomanduar 19 masa me vlerë 83,767,657 lekë, deri me datë 30.09.2019, janë arkëtuar 2,403,429 leke, ndërsa shuma 81,419,908 lekë nuk është arkëtuar dhe është kontabilizuar vlera prej 75,915,662 lekë.</p>	56 – 57 dhe aneks E	I mesëm	Kryetari i Bashkisë Klos të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara të KLSH në auditimin e mëparshëm, si masa shpërblim dëmi dhe masa organizative.

I.c. OPINIONI I AUDITIMIT

Opinionit i auditimit.

Opinionit i auditimit mbi pasqyrat financiare.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Klos, për vitin ushtrimor, nga 1 Janar 2018 deri 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e gjendjes ekonomike, pozicionit financiar



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

(hyrjeve dhe daljeve (pagesave) në para, pasqyra e amortizimit, shënimet shpjeguese që shoqëronin këto pasqyra.

Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Opinion i pakualifikuar (me rezervë):

Sipas mendimit tonë, përveç çështjes së theksuar në paragrafin e “Bazës për Opinionin e Modifikuar me rezervë”, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare më datë 31 dhjetor 2018, referuar Ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK), mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare.

Baza për opinion e pakualifikuar me rezervë: Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të institucioneve supreme të auditimit (ISSAI). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin “Përgjegjësitë e audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare” të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, e theksuar kjo në ISSAI-n 10-Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30-Kodi Etik, në përputhje me kërkesat etike që janë të rëndësishme në auditimin pasqyrave financiare në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë Kodin e Etikës të KLSH dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë me rezervë, të trajtuara më hollësisht në raportin Përfundimtar.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Klos

Drejtimi i Bashkisë Klos, është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe kontrollin e brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Staf i drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuar. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar. Staf i drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomalitë materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË
USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr.154/14, datë 27.11.14 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr.604/1, datë 26.08.2019 “Auditim financiar dhe përputhshmërie në Bashkinë Klos”, dhe shkresës nr. 604/2, datë 26.08.2019, të miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 02.09.2019 deri më datë 15.10.2019., në subjektin Bashkia Klos, për periudhën nga 01.01.2017 – 30.06.2019, u krye auditimi “Auditim financiar dhe përputhshmërie” nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. **L.B., Përgjegjës Grupi**
2. **A.H., Auditues**
3. **J.P., Auditues**

Titulli: Auditim financiar në Bashkinë Klos.

Marrësi: Bashkia Klos.

Objektivat dhe qëllimi: Dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare të Bashkisë Klos, për vitin 2018 dhe dhënia e opinionit të përputhshmërisë në lidhje me kuadrin rregullator në fuqi. Auditimi u shtri në vlerësimin e pasqyrave të Bashkisë Klos.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është të rrisim shkallën e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë financiare.

Kjo përgjegjshmëri ka të bëjë drejtpërdrejt me menaxhimin e shëndoshë financiar si dhe me faktin që, rezultatet e përdorimi i burimeve janë të paraqitura drejt dhe në përputhshmëri me kornizën e raportimit financiar.

Audituesit shtetërorë do të japin sigurinë ose jo nëse informacioni i paraqitur mbi shpenzimin e parave publike në programet publike përfaqëson në mënyrë të përshtatshme situatën financiare.

Identifikimi dhe përshkrimi i çështjes: Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundësuar kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t'i shërbej subjektit në marrjen e masave në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.

Sipas përcaktimit të ISSAI 100 “Auditimi i përputhshmërisë, përcakton se deri në çmasë subjekti i audituar ndjek rregullat, legjislacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara apo kushtet e përcaktuara si, kushtet e kontratës apo klauzolat e një marrëveshjeje financimi”, duke ofruar raporte të besueshme për fondet nëse janë administruar dhe të drejtat e qytetarëve për një proces të rregullt, nëse janë respektuar siç kërkohet nga kuadri ligjor, rregullator në fuqi.

Ai promovon përgjegjshmëri ndaj devijimeve të raportimit dhe ndaj shkeljeve të kuadrit ligjor rregullator, në mënyrë që të mund të merren veprime korigjuese dhe personat përgjegjës të përgjigjen për veprimet e tyre, duke identifikuar dobësitë dhe devijimet nga ligjet dhe rregulloret, si dhe duke vlerësuar rregullshmërinë aty ku kuadri ligjor rregullator rezulton i pamjaftueshëm dhe/ose i papërshtatshëm.

Mashtrimi dhe korrupsioni, për shkak të natyrës së tyre, përmbajnë elementë që janë në kundërshtim me transparencën, përgjegjshmërinë dhe administrimin e mirë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

Auditimi ka përfshirë veprimet e kryera nëpërmjet bankës, hartimi i pasqyrave financiare, planifikimi dhe mbledhja e të ardhurave, menaxhimin financiar dhe kontrollin, hartimi e zbatimi i buxhetit, auditimin e kontrollit të brendshëm. Gjithashtu auditimi ka përfshirë edhe zbatimin e procedurave të prokurimit, zbatimin e kontratave të punimeve, si dhe zbatimin e detyrave të lëna nga auditimi i mëparshëm.

Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përsa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko financiare të Bashkisë Klos.

Identifikimi dhe përshkrimi i çështjes:

Strukturat drejtuese të Bashkisë Klos, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare dhe në të njëjtën kohë janë përgjegjës për aktivitetin financiar të Bashkisë Klos, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë por pa u kufizuar në Ligjin e Buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, Ligjin e Prokurimeve dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, Ligjin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Standardet e auditimit të aplikuara në kryerjen e auditimit

Auditimi u bazua në Ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 196, datë 29.12.15, referenca të tjera ligjore dhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit:

-ISSAI 100 - (Parimet themelore të auditimit të sektorit publik) që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi.

-ISSAI 200 - (Parimet themelore të auditimit financiar) që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të pasqyrave financiare,

-Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve IFAC,

-Manualin e Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve,

-Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi auditimin financiar”,

-Kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (IPSAS),

-Në praktikat më të mira të fushës,

-Ligji nr. 10296, datë 08.07.10 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”,

-Ligji nr. 9228, datë 29.04.04 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar,

-Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30 datë 27.12.11 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik”.

-UMF nr. 14, datë 28.12.06, “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 06, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre” i ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.07.

-Ligjin nr. 139/15 dt. 17.12.15 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

Administratori i Përgjithshëm (Nëpunësi autorizues) z. I.H. - Kryetar i Bashkisë Klos dhe (Nëpunësi zbatues) znj. Fitnete Krosi – Drejtore e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare.

Administratori i përgjithshëm dhe Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Klos.

Bazuar në pikën 6 e nenit 34, të ligjit nr. 139/15, dt. 17.12.15 “Për vetëqeverisjen vendore”, ku thuhet se: “Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore harton, miraton, zbaton dhe administron çdo vit buxhetin e vet, pa deficit, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon administrimin e zbatimin e sistemit buxhetor dhe ligjin për financat vendore”.

Neni 91. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi: pika 1.3. Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës:

- a) krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre;
- b) vendosin taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- c) hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë buxhetin e tyre;
- ç) mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit.

Neni 65; “Administrata e njësisë administrative”, pika 1. “Në njësitë administrative funksionon administrata që drejtohet nga administratori”.

Përgjegjësitë e audituesve të KLSH për auditimin e pasqyrave financiare:

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare Bashkisë Klos dhe një opinion në lidhje me përputhshmërinë e aktivitetit të subjektit të audituar në lidhje me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, prokurimin dhe menaxhimin financiar dhe kontrollin. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së mbledhur të auditimit.

Parimet e auditimit financiar: Në punën tonë audituese jemi mbështetur në parimet e mëposhtme:

- Etika dhe pavarësia;
- Kontrolli i cilësisë
- Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre
- Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.

Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim:

Përkatësia: Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.

Plotësia: Te gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar

Saktësia: Shumat dhe të dhëna të tjera lidhur me transaksionet e regjistruara dhe ngjarjet janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme

Periudha: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël

Klasifikimi: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura

Ligjshmëria dhe rregullsia: Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion

Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

Ekzistenca: asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto ekzistojnë

Të drejtat dhe detyrimet: Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet, detyrimet dhe janë obligimet e subjektit

Plotësia: Të gjitha asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar

Vlerësimi dhe alokimi: Aktivitetet, pasivitetet dhe interesat e kapitalit janë të përfshira në pasqyrat financiare dhe shumatat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese

Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e shpalosura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.

Plotësia: Te gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.

Klasifikimi dhe kuptueshmëria: Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe të përshkruara dhe shënimet e kanë shprehur qartë.

Saktësia dhe vlerësimi: Informacioni financiar dhe të tjera është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasi të duhur.

Kriteret e vlerësimit. Auditimi u bazua në ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 196, datë 29.12.15, referenca të tjera ligjore dhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit:

-ISSAI 100 - (Parimet themelore të auditimit të sektorit publik) që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi.

-ISSAI 0 - (Parimet themelore të auditimit financiar) që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të pasqyrave financiare,

-Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve IFAC,

-Manualin e Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve,

-Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi auditimin financiar”,

-Kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (IPSAS),

-Në praktikat më të mira të fushës,

-Ligji nr. 10296, datë 08.07.10 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”,

-Ligji nr. 9228, datë 29.04.04 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar,

-Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30 datë 27.12.11 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik”.

-UMF nr. 14, datë 28.12.06, “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 06, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre” i ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.07.

-Ligjin nr. 139/15 dt. 17.12.15 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin.

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar.

Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës për vitin 2018 ka marrë në konsideratë pragun e materialitetit prej **2%**, vlerën **6,437,815** lekë për tu konsideruar. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, u përdorën teknikat e auditimit:

1. Kontrolli aritmetik. Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese. Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, dt. 27.12.11 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese. Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

4. Kontrolli i vlerësimit. Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët, Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduara) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.

6. Kontrolli sipas një treguesi. Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabile. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

III PËRSHKRIMI AUDITIMIT

Informacioni i Përgjithshëm:

Zona Gjeografike: Bashkia Klos gjendet në pjesën qendrore-malore të territorit të Republikës së Shqipërisë dhe kufizohet: në lindje me Bashkitë Bulqizë dhe Dibër; në veri me Bashkinë Mat; në jug me Bashkinë Tiranë; në perëndim me Bashkitë Mat, Krujë dhe Tiranë. Bashkia ka një sipërfaqe prej 258 km², sipërfaqja e tokës bujqësore është 7,897 ha, ndërsa pjesa tjetër përbëhet nga pyje, kullota, lëndina, kreshta, etj. Territori i bashkisë përshkohet nga lumi Mat



Popullsia: Popullsia e bashkisë sipas regjistrimit të bërë nga censusi ishte rreth 21 mijë banorë, ndërsa nga burimet zyrtare të bashkisë rezulton rreth 15.3 mijë banorë, me një dendësi prej 78 banorë për km².

Bashkia Klos është një bashki në Rrethin e Matit në Shqipëri. Më parë quhej Komuna Klos. Ajo ka si qendrën e saj kryesore qytezën e Klosit. Në territorin administrativ të kësaj bashkie përfshihen qyteza e Klosit dhe 30 fshatra, që janë pjesë përbërëse e 4 Nj.A. të Klosit, Suçit, Gurrës dhe Xibrit.

Profili i bashkisë

Me vendim të KM janë një sërë pasurish natyrore që janë shpallur monumente natyrore, monumente kulture dhe monumente historike. Në këtë zonë mund të përmendim disa monumente si: Rruga e vjetër e Arbrit, Ura e Allamanit, Ura e Vashës, Kalaja e Xibrit, Sarajet e Zogut, Varri i turkut, Kulla e Dedollit, etj.

Aktualisht në Bashkinë Klos ushtrojnë aktivitet rreth 200 subjekte private në fusha të tilla si: tregeti, shërbime dhe nxjerrje minerali kromi. Sektori shëndetësor përfaqësohet me 20 qendra shëndetësore. Sektori arsimor përbëhet nga 3 shkolla të mesme dhe disa shkolla 9-vjeçare të shpërndara në njesitë e bashkisë. Ndër prioritet kryesore për bashkinë është zhvillimi i qëndrueshëm i bujqësisë dhe blegtorisë, duke mos lënë pas dore promovimin e turizmit.

NJA	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
Klos	Qyteti: Klos, Fshatrat: Bejni, Beli, Bershini, Cerruja, Darsi, Fshati, Fullqeti, Klos Katund, Patini, Plani i Bardhë, Plesha, Shëngjun, Unjata
Xibër	Fshatrat: Xibër, Shkallë, Guri i Bardhë, Xibër-Murriz, Xibër-Hane, Ketë
Gurrë	Fshatrat: Ripa, Gurra e Vogël, Misherit, Shulbatra, Domi, Gurra e Madhe
Suç	Fshatrat: Kurdari, Kuqelaj, Suç, Skënderaj, Kujtim

Misioni për njësinë që auditohet është: Kryerja e funksioneve të veta, të përbashkëta dhe të deleguara në interes të komunitetit, duke përdorur në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme burimet natyrore dhe financiare (të ardhurat e veta, grandin dhe fondet e dhëna nga buxheti i shtetit me synim krijimin e kushteve të sigurisë dhe mirëqenies për komunitetin).

Objektivat burojnë nga ligji “Për vetëqeverisjen vendore”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

Ndërsa administrata (aparati) i këtij institucioni ka si qëllim: përmirësimin e kushteve të punës, rritjen e nivelit të drejtimit dhe rishikimin funksional të Bashkisë, zhvillimin e politikave dhe strategjive, identifikimin, koordinimin dhe monitorimin e programeve, rritjen e efektivitetit të përdorimit të burimeve.

Bashkia siguron qeverisjen në një nivel sa më afër shtetasve nëpërmjet: njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësisë; respektimit i të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera; zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësirave të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë; ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga Bashkia; realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme dhe nxitjes efektive të pjesëmarrjes së bashkësisë në qeverisjen vendore.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MBI PLANIFIKIMIN DHE VLERËSIMIN E RISKUT.

Oasja dhe metodologjia e auditimit.

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar.

Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës për vitin 2018 ka marrë në konsideratë pragun e materialitetit prej **2%**, vlerën **6,437,815** lekë për tu konsideruar. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti.

Mbi vlerësimin e riskut.

Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit.

Më poshtë po citojmë disa ngjarje që mund të paraqesin një risk të gabimit material:

- Kontrolli i brendshëm:

Kontrolli i brendshëm në ndërmarrje nuk ka funksionuar i plotë, nuk përfshin gjithë veprimtarinë e njësisë ekonomike, si rrjedhim nuk ndihmon në verifikimin e realizimit të detyrave dhe njësisia ekonomike nuk mund ta dijë ku mundet të ndodhin parregullsitë, shmangiet nga normat dhe kriteret e veprimtarisë ekonomike. Zbatimi i rregullt i procedurave të kontrollit të brendshëm shërben për ti siguruar menaxherët se pasuria e njësisë është e mbrojtur, të dhënat e përpunuara në kontabilitet janë të besueshme.

- Konfirmimet nga të tretët:

Subjekti që auditohet nuk ka të konfirmuara (*Rakorduara*) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose regjistrimeve të tjera.

- Transaksionet:

Janë kryer transaksione me vlera të rëndësishme me palë të treta, jo rutinë në periudhën e fundit të vitit ushtrimor.

Nisur nga ky fakt bazuar në vlerën e materialitetit të përlogaritur (**6,437,815** lekë) u filtruan:

- Të gjitha Urdhër Shpenzimet e kontabilizuara në ditarin e bankës mbi këtë vlerë për muajin nëntor - dhjetor 2017 në vlerën totale 74,840,803 lekë.

- Të gjitha Urdhër Shpenzimet e kontabilizuara në ditarin e bankës mbi këtë vlerë për muajin nëntor - dhjetor 2018 në vlerën totale 54,110,230 lekë.

Urdhër Shpenzimet e filtruara u audituan në funksion të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik*” për regjistrimin e veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim si; *Dokumentet autorizues, Dokumente vërtetues, Dokumente të kontabilitetit, etj.*

- Kontabiliteti:

Në nenin 10 të Ligjit nr. 9228, dt. 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” përcaktohen parimet-bazë për mbajtjen e kontabilitetit dhe përgatitjen e pasqyrave financiare, në përputhje me këtë ligj, si dhe me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, publikuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit. (SKK 1) i përmirësuar.

Mos aplikimi i rregullave kontabël mbi bazën e parimit të kontabilitetit pra mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

Me qëllim që të përmbushin objektivat e tyre, pasqyrat financiare përgatiten mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Sipas kësaj metode, efektet e transaksioneve dhe ngjarjeve të tjera njihen në pasqyrat financiare kur ato ndodhin (dhe jo kur para ose ekuivalentet e saj arkëtohen ose paguhen) dhe regjistrohen në kontabilitet dhe raportohen në pasqyrat financiare të periudhave kontabël, të cilave u përkasin. Pasqyrat financiare, të përgatitura në bazë të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, i informojnë përdoruesit jo vetëm mbi transaksionet e shkuara të shoqëruara me arkëtime dhe pagesa, por edhe mbi detyrimet për t’u paguar në të ardhmen si dhe mbi aktive që do të sjellin arkëtime në të ardhmen. Në këtë mënyrë, ato paraqesin informacione mbi transaksionet dhe ngjarjet e shkuara të cilat u shërbejnë përdoruesve më së miri në marrjen e vendimeve ekonomike. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar. Përcaktimi i riskut dhe materialitetit për Bashkinë Klos për vitin 2018, në lidhje me shpenzimet dhe të ardhurat paraqitet në tabelat nr.1 dhe nr.2 sa më poshtë vijon:

Tabela nr.1 “Bashkia Klos, plani në total, të dhëna të tjera mbi planin në lidhje me shpenzimet”

Emërtimi i Shpenzimeve	Vlera e Popullatës	Faktori i Riskut (0.7-2-3)	Çështje për tu shqyrtuar
Paga (600)	99,102,337	0.70	11
Sigurime Shoqërore (601)	17,907,437	0.70	2
Mallra e Shërbime (602)	55,264,950	0.70	6
Investime të brend. (230-231)	10,822,704	2.00	3
Te tjera transfer. korrente (606)	214,298,563	0.70	23
Total	397,395,991		
Materialiteti në %	2%		
Materialiteti në vlerë	7,947,920		
<i>Kalkulimi i precizionit</i>			
Materialiteti	7,947,920		
<i>Gabimi i lejuar (10% - 20%)</i>	794,792		
Nëntotali	7,153,128		
<i>Precizioni i planifikuar (80-90%)</i>	90%		
Vlera e precizionit	6,437,815		

Baza e të dhënave: Bashkia Klos.

Tabela nr.2 “Bashkia Klos, plani në total, të dhëna të tjera mbi planin, në lidhje me të ardhurat”.

Emërtimi i të ardhurave	Vlera e Popullatës	Faktori i Riskut (0.7-2-3)	Çështje për tu shqyrtuar
Të ardhurat nga buxheti	421,789,163	0.70	41
Të ardhurat e veta	26,785,670	0.70	3
Total	448,574,833		
Materialiteti në %	2%		
Materialiteti	8,971,497		
<i>Kalkulimi i precizionit</i>			
Materialiteti	8,971,497		
<i>Gabimi i lejuar (10%-20%)</i>	897,150		
Nëntotali	8,074,347		
<i>Precizioni i planifikuar (80 -90%)</i>	90%		
Vlera e precizionit	7,266,912		

Baza e të dhënave: Bashkia Klos.

A/3. KONTROLLI I BRENDSHËM.

3.1. Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK. Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike që mbulon;

Në drejtim të vlerësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Bashkinë Klos, nga Grupi i Auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij për të gjithë komponentët, konkretisht:

- Mjedisi i kontrollit;
- Menaxhimi i riskut;
- Aktivitetet e kontrollit;
- Informimi dhe komunikimi;
- Monitorimi

Ky auditim u krye në zbatim të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ndryshuar, si aktet ligjore e nënligjore dalë në zbatim të tij, për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike, si dhe si ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- veprimtarive efektive, të efektshme dhe me ekonomi;
- pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Nga Bashkinë Klos, Grupit të Auditimit ju vu në dipozicion dokumentacioni i mëposhtëm:

- Rregullore e Funksionimit të Brendshëm të Bashkisë Klos.
- Raporte monitorimi;
- Gjurmë auditimi dhe hartë procesesh për disa operacione etj.

Nga auditimi rezultoi se ka gjetur zbatim ligji për MFK, me përjashtim të gjetjes sa më poshtë vijon:

Gjetje nr.1 Mbi zbatimin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Bashkinë Klos.

- Situata:**
1. Rregullorja e brendëshme nuk është në koherencë të plotë me strukturën aktuale të Bashkisë;
 2. Nuk ka kod etik të vecantë, por në rregulloren e brendëshme të funksionimit, në nenin 8, “Etika për punonjësit e Bashkisë Klos dhe kodi i veshjes” flitet për këtë kod;
 3. Nuk ka në rregulloren e brendshme, procedura mbi trajtimin e rasteve të shkeljeve apo thyerjes së disiplinës nga ana e stafit, por deri diku janë parashikuar në kontratën individuale të punës.
 4. Gjatë periudhës së auditimit nuk janë kryer vlerësime periodike të stafit, por vetëm vlerësime të stafit të ri pas periudhës së provës.
 5. Nuk ka plane trajnimi të miratuar, pavarësisht se janë bërë trajnime kryesisht nga të tretë, për persona të caktuar
 6. Nga Bashkinë Klos, nuk ka manuale mbi procedurat për operacionet kryesore, por ato janë përshkruar në rregulloren e brendshme.
 7. Nuk ka rregulla të brendshme që garantojnë sigurinë e sistemit IT.
- Kriteri** Ligji nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

kontrollin”, ndryshuar, si aktet ligjore e nënligjore dalë në zbatim të tij

Impakti	Ndikim në mbarëvajtjen e funksionimit dhe menaxhimit të proceseve.
Shkaku	Moszbatimi i plotë i akteve ligjore të sipërcituara.
Rëndësia:	I mesëm.
Rekomandimi	Nga ana e Bashkisë Klos të merren masa për: - përputhjen e rregullores së brendshme të funksionimit me strukturën organizative si dhe të përcaktohen procedura për trajtimin e rasteve të shkeljeve apo thyerjes së disiplinës nga ana e stafit; - hartimin e kodit etik; - hartimin e manualeve mbi procedurat për operacionet kryesore - kryerjen e vlerësimeve periodike të stafit; - përcaktimin e rregullave që të garantojnë sigurinë e sistemit IT
Afati për zbatim	Menjëherë.

Më hollësisht trajtuar në ANEKS A, bashkëlidhur.

3.2 Mbulimi me auditim i aktivitetit të Bashkisë, referuar kërkesave ligjore. Rezultatet dhe eficaenca e strukturave të ngritura për realizimin e auditit të brendshëm. Organizimi dhe funksionimi i njësive të auditit të brendshëm publik, kapacitetet audituese që mbulojnë këtë aktivitet, Planifikimi, realizimi i programit vjetor të auditimit dhe analiza sipas llojeve dhe gjetjeve si dhe kapacitetet audituese të sektorit të auditimit. Ndjekja e zbatimit të masave të rekomanduara nga drejtimi”

- Organizimi dhe funksionimi i Njësive të Auditit të Brendshëm Publik për periudhën 2017-30.09.2019.

Bazuar në VKM nr.83, datë 03.02.2016, “Për miratimin e kriterëve për ngritjen e njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, Njësia e Auditit të Brendshëm, Bashkia Klos është pjesë përbërëse e Strukturës Organizative të Bashkisë.

Për vitin 2017, kjo strukturë është miratuar me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 27, datë 01.03.2017, e përbërë nga **tre punonjës**, një përgjegjës si dhe dy auditues.

Për vitin 2018, kjo strukturë është miratuar me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 18, datë 01.02.18, e përbërë nga **tre punonjës**, një përgjegjës dhe dy auditues.

❖ Mos plotësimi i organikës së miratuar me tre punonjës për NjAB, është në kundërshtim me ligjin nr. 114, datë 22.10.2015, “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” dhe VKM nr. 83, datë 03.02.2016, “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”.

Për vitin 2019, kjo strukturë është miratuar me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 14, datë 01.02.2019 e përbërë nga **1 punonjës**, përgjegjës.

Në fakt nga auditimi rezultoi se për periudhën 01.01.2017 deri me 30.09.2019, **kjo strukturë ka funksionuar me një punonjës, me detyrën e përgjegjës.**

Përgjegjës i AB është z.V.K., me arsim të lartë, Fakulteti i Drejtësisë, Dega Juridik. Është emëruar në këtë detyrë sipas Vendimit për emërim të përkohshëm në punë të Titullarit të Bashkisë Klos, nr.37, datë 17.05.2017, me fillim të marëdhënive financiare më 17.05.2017.

Sipas këtij urdhri, në pikën 4 është përcaktuar se “Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe Juridike të marrë masa për zbatimin e procedurave ligjore për plotësimin e vendit vakant në përputhje me ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”.

Nga ana e kësaj drejtorie nuk ka shpallje për vend vakant.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

Për këtë punonjës nuk ka asnjë kontratë pune dhe as vazhdim të procedurave për fitim e statusit të nëpunësit civil, nuk është me statusin e nëpunësit civil.

Ky punonjës nuk ka eksperiencë punë si audit sipas dosjes të vënë në dispozicion nga Drejtoria e shërbimit social dhe burimeve njerëzore

Nga auditimi rezulton se përgjegjësi, ka vërtetim datë 30.09.2019 se ka kryer certifikimin si audit i brendshëm nr.17424/1, datë 30.09.2019, por nuk e ka marrë këtë certifikim si dokument.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se:

-Nuk është hartuar **manuali specifik** i AB.

-Nuk ka **Kartë të Auditit të Brendshëm** kërkesë e nenit nr.12, pika c, nenit 14, pika b dhe nenit 24, pika c të ligjit nr.114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e brendshëm në Sektorin publik” dhe shkronja a, neni 64 të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 për “Vetqeverisjen vendore”.

Për vitin 2017, është hartuar **Plani Strategjik** dhe ai **vjetor** për vitet 2018-2020, plan i cili mbas miratimit nga Titullari i Bashkisë është dërguar në Ministrinë e Financave, në NJQHAB me numër prot., 2212, datë 20.10.2017 Për vitin 2018, është hartuar **Plani Strategjik** dhe ai **vjetor** për vitet 2018-2020, plan i cili mbas miratimit nga Titullari i Bashkisë është dërguar në Ministrinë e Financave, në NJQHAB me shkresën nr.246, datë 04.02.2019,

Për vitin

Për vitin 2017, 2018 e 2019 nuk ka planifikim të auditimeve dhe nuk u paraqit një I tillë.

Gjetje nr.2 Mbi funksionimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm.

Situata:

- Nuk ka plane auditimi të miratuar nga titullari sipas të dhënave për vitet 2017-9 mujor 2019.
- Organika e Njesisë së auditit të brendshëm për vitet 2017-108 ka qenë e pa plotësuar.
- Në lidhje me emërimin në detyrë të përgjegjësit të sektorit të AB, konstatohet se ai është emëruar pa plotësuar kushtet e nenit 11 “Punësimi i audituesit të brendshëm”, të ligjit nr.114/2015, “Për auditivin e brendshëm në sektorin publik”, pika b, c dhe ç;
- Përgjegjësi i AB nuk është punësuar sipas kërkesës së pikës 3 të nenit 11, të të ligjit nr.114/2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”;
- Nuk është hartuar **manuali specifik** i AB.
- Nuk ka **Kartë të Auditit të Brendshëm** kërkesë e nenit nr.12, pika c, nenit 14, pika b dhe nenit 24, pika c të ligjit nr.114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e brendshëm në Sektorin publik” dhe shkronja a, neni 64 të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 për “Vetqeverisjen vendore”.
- Mungon dokumentacioni i dosjeve të auditimit sipas kërkesave të Manualit të Auditit të Brendshëm, Kapitulli VI, “Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese”;
- Dokumentacioni për auditimet e kryera në përgjithësi është i pa protokolluar.

Kriteri

Ligji nr.114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e brendshëm në Sektorin publik”

Manualit të Auditit të Brendshëm.

VKM nr.83, datë 03.02.2016, “Për miratimin e kriterëve për ngritjen e njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

Impakti	Detyrat e përcaktuara në rregulloren e brendëshme të funksionit, neni 26, “Detyrat kryesore të Përgjegjësit të Sektorit”.
Shkaku	Ndikim në mbarëvajtjen e funksionimit dhe menaxhimit të proceseve.
Rëndësia:	Moszbatim i kërkesave të akteve ligjore të sipërcituara,
Rekomandimi	I lartë
Afati për zbatim	Nga ana e Bashkisë Klos të merren masa për vënien në funksion të Sektorit të Auditimit të Brendshëm.
	Menjëherë.

Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi V.K., me detyrë përgjegjës i Sektorit të Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Klos.

Më hollësisht trajtuar në ANEKS A, bashkëlidhur materialit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

B. Mbi planifikimin dhe zbatimimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në R.SH”, ndryshuar me ligjin nr. 114/2012/datë 07.12.2012 dhe ligjin nr.57/2016, datë 2.6.2016), ligjin nr.130/2016, datë 17.12.2016 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2017”, dhe ligjin nr.109/2017, datë 30.11.2017“Për buxhetin e shtetit të vitit 2018”, me ndryshimet.

1. Programimi i PBA 2017-2019 dhe programimi i buxhetit vjetor 2017 dhe 2018;
2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura;
3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit;
4. Burimi i krijimit të të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor;
4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve dhe niveli i realizimit të të ardhurave; (Faturat e palikuiduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj, sipas raportimit në MF)
5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfutuara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre;

1. Programimi i PBA 2017-2019 dhe programimi i buxhetit të viteve 2017, 2018 dhe 2019

Treguesit ekonomikë dhe financiarë të Bashkisë Klos për Buxhetin afatmesëm, për periudhën 2017-2019 janë miratuar me VKB Klos nr.138, datë 24.10.2016. Në zbatim të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe të shkresës së Ministrisë së Financave (Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit), Bashkia Klos ka hartuar programin buxhetor afatmesëm 2017-2019 me masat përkatëse për zbatimin e tij. Për këtë qëllim është krijuar Grupi për Strategji, Buxhet dhe Integrim (GSBI) i përbërë nga 5 persona: B.Ç., A.Ç., F.K., G.C. dhe B.D. Nga Grupi për Strategji Buxhet dhe Integrim (GSBI), me urdherin nr. 18 datë 21.04.2016 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2017-2019” është miratuar PBA 2017-2019 nga Këshilli i Bashkisë,

Mbi hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2018-2020:

Treguesit ekonomikë dhe financiarë të Bashkisë Klos për Buxhetin afatmesëm, për periudhën 2018-2020 janë miratuar me VKB Klos nr. 182, datë 24.04.2017

Në zbatim të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe të shkresës së Ministrisë së Financave (Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit nr. 1623/1 datë 28.07.2017), Bashkia Klos ka hartuar programin buxhetor afatmesëm 2018-2020 me masat përkatëse për zbatimin e tij. Për këtë qëllim është krijuar Grupi për Strategji, Buxhet dhe Integrim (GSBI) me vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 182 datë 24.04.2017 i përbërë nga 5 persona: B.Ç., A.Ç., F.K., G.C. dhe B.D. Nga Grupi për Strategji Buxhet dhe Integrim (GSBI), me vendimin nr. 181 datë 24.04.2017 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2017-2019” është miratuar PBA 2017-2019 nga Këshilli i Bashkisë. Me shkresën nr. 1623/1 datë 28.07.2017 nga Bashkia Klos është dërguar Programi buxhetor Afatmesëm 2018-2020 në Ministrinë e Financave, së bashku me relacionin përkatës. Me shkresën nr. 8909/2 prot. datë 21.08.2017 të MF, “Dërgohen mendimet mbi PBA-në 2018-2020”, janë dërguar nga MF mendimet rreth dokumentit të parë të PBA-së 2018-2020. Në dokumentin final të PBA-së 2018-2020, u konstatua që janë reflektuar sugjerimet e dhëna nga MF në lidhje me projekt-buxhetin e paraqitur në fazën e parë.

Mbi hartimin e dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021:

Treguesit ekonomikë dhe financiarë të Bashkisë Klos për Buxhetin afatmesëm, për periudhën 2019-2021 janë miratuar me VKB Klos nr. 67, datë 23.07.2018. Është miratuar kalendari i PBA-së 2019-2021. Është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me urdhër të brendshëm të kryetarit nr. 15 datë 31.01.2018, si dhe urdhëri për ngritjen e EMP-së nr. 50 datë 12.03.2018. Janë miratuar me VKB Klos nr. 57, datë 21.05.2018 tavanet e PBA-së 2019-2021, të konfirmuara nga prefekti i qarkut Dibër me shkresën nr. 805/1 datë 28.05.2018. Jane



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

organizuar dëgjesa publike të dokumentuara me fotografi. Me shkresën nr. 1373 datë 01.06.2018, janë dërguar në ministri tavanet e PBA-së bashkë me Instrumentin e Planifikimit Financiar. Me shkresën nr. 11714 datë 19.06.2018, nga ministria janë dërguar mendimet mbi PBA 2019-2021. Vërejtjet dhe sugjerimet e Ministrisë janë miratuar me vendimin nr. 67 datë 23.07.2018 “*Mbi miratimin e PBA-së 2019-2021*”. Me VKB-në Klos nr. 77 janë miratuar Tavanet Përfundimtare të PBA-së 2019-2021 dhe janë dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit dhe Borxhit Publik. Me shkresën nr. 2313 datë 12.09.2018 janë dërguar në Ministri Tavanet Përfundimtare, së bashku me relacionin shpjegues si dhe FPT-në për fazën e dytë të PBA-së 2019-2021.

Mbi hartimin e dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022:

Treguesit ekonomikë dhe financiarë të Bashkisë Klos, për buxhetin afatmesëm, për periudhën 2020-2022 me VKB-në Klos nr. 57, datë 24.06.2019. Është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me urdhër të brendshëm nr. 35 datë 11.02.2019 të kryetarit të bashkisë, si dhe urdhëri nr. 36 datë 11.03.2019, për ngritjen e EMP-së. Janë miratuar me VKB Klos nr. 20 datë 25.03.2019 tavanet e PBA-së 2020-2022, të konfirmuara nga prefekti i qarkut Dibër me shkresën nr. 434/1 datë 01.04.2019. Janë organizuar dëgjesa publike të shoqëruara me fotografi. Me shkresën nr. 1259 datë 31.05.2019, tavanet e PBA-së bashkë me Instrumentin e Planifikimit Financiar janë dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Me shkresën nr. 11597 datë 18.06.2019 nga ministria janë dërguar mendimet mbi PBA-në 2020-2022. Vërejtjet dhe sugjerimet e Ministrisë janë miratuar me vendimin nr. 57 datë 24.06.2018, për miratimin e PBA-së 2020-2022. Me VKB-në Klos nr. 81, janë miratuar Tavanet Përfundimtare të PBA-së 2020-2022 dhe janë dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit dhe Borxhit Publik. Me shkresën nr. 1854/3 datë 09.09.2019 janë dërguar në Ministri tavanet përfundimtare, së bashku me relacionin shpjegues si dhe FPT-në për fazën e dytë të PBA-së 2020-2022.

Programi i të ardhurave për vitin 2017 është bërë mbi bazën e paketës fiskale të miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 143 dt. 25.11.2016 të këshillit të Bashkisë “*Për miratimin e paketës fiskale, taksave dhe tarifave vendore për vitin 2017 në Bashkinë Klos*”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me shkresën 1263/1 Prot., datë 06.12.2016.

Programi i të ardhurave për vitin 2018 është bërë mbi bazën e paketës fiskale të miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 262 dt. 22.12.2017 të këshillit të Bashkisë “*Për miratimin e paketës fiskale, taksave dhe tarifave vendore për vitin 2018 në Bashkinë Klos*”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me shkresën 2009/1 Prot., datë 27.12.2017. Buxheti i Bashkisë për vitin 2017 është hartuar dhe miratuar në Këshillin e Bashkisë, me VKB-në nr. 158, datë 13.02.2017 “*Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë Klos për vitin 2017*” miratuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me shkresën nr. 286/1, datë 20.02.2017.

Programi i të ardhurave për vitin 2019 është bërë mbi bazën e paketës fiskale të miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 120 datë 20.12.2018 të KB Klos, “*Për miratimin e paketës fiskale, taksave dhe tarifave vendore për vitin 2019*”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me shkresën nr. 2025/1, datë 26.12.2018. Buxheti i Bashkisë për vitin 2018 është hartuar dhe miratuar në Këshillin e Bashkisë, me VKB-në nr. 122 datë 20.12.2018 “*Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë Klos për vitin 2018*” miratuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me shkresën nr. 2085/1, datë 27.12.2018.

Në lidhje me shpenzimet, përsa i përket zërit të pagave, paraqitet në këto nivele: Për vitin 2017 në shumën 99,270,321 lekë, në vitin 2018 ishte parashikuar 99,990,321 lekë dhe për vitin 2019 është parashikuar që ky fond të jetë në vlerën 99,000,321 lekë. Në të dhënat e mësipërme për fondin e pagave, në vitin 2018 është parashikuar një rritje nga 9% çdo vit, për të përballuar efektet nga ndryshimi i vjetërsisë, kualifikimit si dhe ndryshimit të nivelit të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

pagës së grupit. Fondi i pagave zë afërsisht 46% të buxhetit total të Bashkisë, pasi pas reformës territoriale është rritur numri i punonjësve të cilët paguhen nga transfertat specifike dhe shpenzimet operative kanë qëndruar në të njëjtat nivele. Në sektorin e arsimit nuk janë shtuar punonjës, pagat e të cilëve janë mbuluar me një fond page dhe sigurimesh me transfertën specifike.

2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura;

Nga auditimi i çeljeve, shtesave dhe ndryshimeve në buxhetet vjetore në Bashkinë Klos, rezultoi se:

Për vitin 2017, sipas zërave të buxhetit rezultoi se në total buxheti i Bashkisë (nga granti, të ardhurat dhe transfertat specifike) është realizuar në masën 87.6% ose nga 623,531,240 lekë të planifikuara në 546,563,439 lekë të realizuara. Fondi i pagave është realizuar 9.2% ose nga 96,207,978 lekë të planifikuara janë realizuar 89,686,513 lekë dhe sigurimet shoqërore në masën 89.2%; nga vlera 17,342,182 lekë të planifikuara janë realizuar 15,462,199 lekë. Po kështu dhe shpenzimet operative rezultojnë të jenë realizuar në masën 93.1% ose nga 294,093,803 lekë të planifikuara, janë realizuar 273,919,420 lekë. Në zërin investime nga 215,887,277 lekë janë realizuar 167,495,307 lekë ose 77.6%. Shpenzimet operative, për kujdesin social dhe të fondit rezervë (602+604+606) nga 14,766,255 lekë të planifikuara janë realizuar në vlerën 5,166,999 lekë ose 35%. Për sa i përket transfertës së kushtëzuar, ku përfshihen PAK+Nd. Ek, Shpenzimet për Gjendjen Civile, QKR apo investime të çelura nga Ministrinë e Linjës, të dhënat paraqiten në këto nivele: Në total nga ky grup fondesh shpenzimet janë realizuar në masën 99.9% ose nga 371,546,348 lekë të planit vjetor janë shpenzuar 371,186,595 lekë. Fondi i pagave është realizuar në masën 96.3%. Nga 2,291,000 lekë janë shpenzuar 2,206,000 lekë. Po kështu fondet e sigurimeve është realizuar në masën 96.2%; nga 383,000 lekë të planifikuara janë shpenzuar 368,396 lekë. Përsa i përket zërit PAK.+ Nd. Ek, rezultoi se nga 221,472,130 lekë janë realizuar 221,471,970 lekë ose 99.9%. Në këtë grup shpenzimesh nga zëri investime, janë planifikuar 115,802,490 lekë dhe janë realizuar 115,802,490 lekë ose afërsisht 100%.

Për vitin 2018, sipas zërave të buxhetit rezultoi se në total buxheti i Bashkisë (nga granti, të ardhurat dhe transfertat specifike) është realizuar në masën 79.7% ose nga 642,733,380 lekë të planifikuara në 512,480,904 lekë të realizuara. Fondet e pagave është realizuar 86.9% ose nga 114,084,947 lekë të planifikuara janë realizuar 99,102,337 lekë dhe sigurimet shoqërore në masën 92.8%, nga vlera 19,290,034 lekë të planifikuara janë realizuar 17,907,437 lekë. Po kështu edhe shpenzimet operative rezultojnë të jenë realizuar në masën 91.3% ose nga 309,988,615 lekë të planifikuara, janë realizuar 282,899,118 lekë. Në zërin investime nga 199,369,784 lekë janë realizuar 112,572,012 lekë ose 56.5%. Shpenzimet operative, për kujdesin social dhe të fondit rezervë (602+604+606) nga 19,273,933 lekë të planifikuara janë realizuar në vlerën 8,962,284 lekë ose 46.5%. Për sa i përket transfertës së kushtëzuar, ku përfshihen PAK+Nd. Ek, Shpenzimet për Gjendjen Civile, QKR apo investime të çelura nga Ministrinë e Linjës të dhënat paraqiten në këto nivele: Në total nga ky grup fondesh shpenzimet janë realizuar në masën 99% ose nga 292,581,213 lekë të planit vjetor janë shpenzuar 289,939,640 lekë. Fondet e pagave është realizuar në masën 99.9% nga 2,278,700 lekë janë shpenzuar 2,277,368 lekë. Po kështu fondet e sigurimeve është realizuar në masën 99.8%; nga 381,000 lekë të planifikuara janë realizuar 380,322 lekë. Përsa i përket zërit PAK.+nd. ek, rezultoi se nga 213,724,000 lekë janë realizuar 211,097,263 lekë ose 98.7%. Në këtë grup shpenzimesh nga zëri investime, janë planifikuar 62,974,149 lekë dhe janë realizuar 62,974,149 lekë ose afërsisht 100%.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

Për periudhën deri në datën 30 shtator 2019, sipas zërave të buxhetit rezulton se në total buxheti i Bashkisë (nga granti, të ardhurat dhe transfertat specifike) është realizuar në masën 62.1% ose nga 656,761,179 lekë të planifikuara në 408,052,373 lekë të realizuara. Fondi i pagave është realizuar 70.8% ose nga 145,282,795 lekë të planifikuara janë realizuar 102,878,678 lekë dhe sigurimet shoqërore në masën 72.7%, nga vlera 20,314,145 lekë të planifikuara janë realizuar 14,765,034 lekë. Po kështu dhe shpenzimet operative rezultojnë të jenë realizuar në masën 70.2% ose nga 295,772,120 lekë të planifikuara, janë realizuar 207,629,143 lekë. Në zërin investime nga 195,392,119 lekë janë realizuar 82,779,518 lekë ose 42.3%. Shpenzimet operative, për kujdesin social dhe të fondit rezervë (602+604+606) nga 40,215,869 lekë të planifikuara janë realizuar në vlerën 11,721,075 lekë ose 29.1%. Për sa i përket transfertës së kushtëzuar, ku përfshihen PAK+Nd. Ek, Shpenzimet për Gjendjen Civile, QKR apo investime të çelura nga Ministrinë e Linjës të dhënat paraqiten në këto nivele: Në total nga ky grup fondesh shpenzimet janë realizuar në masën 72.7% ose nga 261,303,040 lekë të planit vjetor janë shpenzuar 189,956,015 lekë. Fondi i pagave është realizuar në masën 90.7%, nga 1,889,000 lekë janë shpenzuar 1,713,093 lekë. Po kështu fondi i sigurimeve është realizuar në masën 76.7%, nga 381,000 lekë janë shpenzuar 292,188 lekë. Përsa i përket zërit PAK+Nd. Ek, rezulton se nga 201,155,000 lekë janë realizuar 159,179,448 lekë ose 79.1%. Në këtë grup shpenzimesh nga zëri investime, janë planifikuar 54,045,040 lekë dhe janë realizuar 25,902,286 lekë ose afërsisht 47.9%.

Më hollësisht trajtuar në **ANEKS B**, bashkëlidhur.

Gjetjet e konstatuara në lidhje me pikën B, janë sa më poshtë vijon:

Gjetje nr. 3 Probleme në lidhje me procedurat e diskutimit, miratimit, publikimit dhe analizës së buxheteve. Diferenca midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit.

Situata: Në lidhje me procedurën e diskutimit, miratimit, publikimit dhe analizës së buxheteve:

a) Buxheti për vitin 2017 nuk është përgatitur dhe miratuar brenda datës 25 dhjetor të vitit paraardhës.

b) Buxhetet nuk janë paraqitur për miratim brenda muajit nëntor të vitit buxhetor nga kryetari i njësisë të qeverisjes vendore në Këshillin Bashkiak.

c) Nuk është e qartë nëse buxhetet janë publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike brenda 15 ditëve nga miratimi i tyre.

ç) Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore nuk ka bërë analizë të plotë të zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor të çdo viti.

Buxheti i vitit 2017 është miratuar në shkurt të vitit 2018.

Të ardhurat e trashëguara nga viti 2016 në vitin 2017 kanë qenë 12,063,972 lekë dhe nga viti 2017 në vitin 2018 kanë qenë 5,763,634 lekë.

Transferta e pakushtëzuar e vitit 2017 ka qenë 126,912,954 lekë dhe për vitin 2018 ka qenë 131,261,834 lekë.

Transferta specifike faktike për vitin 2017 ka qenë 42,025,239 lekë dhe për vitin 2018 ka qenë 60,805,048 lekë.

Ka diferenca të dukshme midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit, përsa i përket pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve të tyre.

Në Buxhetet e çdo viti janë planifikuar shpenzimet në vazhdim, por jo në të gjitha rastet është zbatuar rradha e financimit.

Për rastet e investimeve nga të ardhurat, një pjesë e prokurimeve janë bërë pa



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

pasur fonde në dispozicion, vetëm në bazë të planifikimit.

Përgjithësisht, pagesat e faturave janë bërë gjatë gjithë vitit, por ka pasur raste (ku investimet e planifikuara për t'u bërë nga të ardhurat) që faturat të paguhen me vonesë, për shkak të mosrealizimit të të ardhurave.

Në lidhje me faturat e palikuiduara: për vitin 2017 nga 14,814,020 lekë të planifikuara janë shpenzuar 14,499,884 lekë dhe për vitin 2018 nga 39,655,776 lekë të planifikuara janë shpenzuar 38,667,121 lekë.

Për vitin 2017, sipas zërave të buxhetit rezultojnë se në total buxheti i Bashkisë (nga granti, të ardhurat dhe transfertat specifike) është realizuar në masën 87.6% ose nga 623,531,240 lekë të planifikuara në 546,563,439 lekë të realizuara.

Për vitin 2018, sipas zërave të buxhetit rezultojnë se në total buxheti i Bashkisë (nga granti, të ardhurat dhe transfertat specifike) është realizuar në masën 79.7% ose nga 642,733,380 lekë të planifikuara në 512,480,904 lekë të realizuara.

Deri në 30.09.2019, sipas zërave të buxhetit rezultojnë se në total buxheti i Bashkisë (nga granti, të ardhurat dhe transfertat specifike) është realizuar në masën 62.1% ose nga 656,761,179 lekë të planifikuara në 408,052,373 lekë të realizuara.

Kriteri:

- Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” nenet 2, 3, 6, 9, 10,15,15, 27 dhe 32, i ndryshuar me Ligjin nr. 114/2012 datë 07.12.2012 dhe Ligjin nr.57/2016, datë 2.6.2016;
- Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, i ndryshuar me Ligjin nr. 9477, datë 9.2.2006;
- Ligji nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9 pika 1.3 germa “c” dhe “ç”;
- Ligji nr. 48/2014 datë 24.04.2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregëtare”, i ndryshuar me Ligjin nr. 24/2015, datë 19.03.2015;
- Ligji nr. 130/2016, datë 15.12.2016 “Për buxhetin e vitit 2017”;
- Ligji nr. 109/2017, datë 30.11.2017 “Për buxhetin e vitit 2018”;
- Akti Normativ Nr. 1, Datë 26.07.2018, “Për Buxhetin e Vitit 2018”;
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenet 2 dhe 3 pika 3;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, i ndryshuar me Udhëzimin nr.5/1 datë 21.05.2014.

Ndikimi/ Efekti:

Paaftësia e menaxhimit për të projektuar, miratuar, realizuar dhe analizuar buxhetet e institucionit që drejton, shkakton në zinxhir degradimin e institucionit nga pikëpamja e funksionimit dhe deri në pamundësinë financiare për të prokuruar mallra dhe shërbime për komunitetin.

Planifikimi i të ardhurave të veta, zërave të shpenzimeve dhe investimeve dhe mos realizimi i tyre, kryesisht për shkak të mosrealizimit të të ardhurave, sjellin mungesa në plotësimin e nevojave reale të komunitetit dhe ulje të performancës të njësive vendore në drejtim të këtyre shërbimeve.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

Shkaku: Analizat e punës për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve në buxhetet paraardhëse nuk janë bërë të plota, duke mos nxjerrë konkuzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve gjatë viteve të audituara.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: 1. Për vitet në vazhdim, kryetari i Bashkisë Klos të marrë masa për diskutimin e buxhetit të vitit pasardhës në këshillin bashkiak brenda muajit nëntor të vitit buxhetor dhe për miratimin përfundimtar të tij jo më vonë se data 25 dhjetor. Këto vendime të publikohen rregullisht brenda 15 ditëve në buletin e Njoftimeve Publike dhe zbatimi i buxhetit të analizohet brenda muajit qershor të çdo viti.

2. Në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, Bashkia Klos të marrë masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve. Të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin e buxheteve paraardhës duke nxjerrë konkuzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse.

Afati i

zbatimit: Menjëherë dhe në vijimësi

Personat

Përgjegjës: I.H., B.Ç., F.K.

Gjetje nr. 4 Parregullsi në kryerjen e pagesave dhe procedura që mundësojnë krijimin e detyrimeve të prapambetura. Nivel i lartë i detyrimeve të prapambetura.

Situata: Nga administrata e bashkisë Klos nuk është ruajtur plotësisht radha e financimit për procedurat e raportuara si të prapambetura.

Në lidhje me faturat e palikuiduara: **për vitin 2017** nga 14,814,020 lekë të planifikuara janë shpenzuar 14,499,884 lekë dhe **për vitin 2018** nga 39,655,776 lekë të planifikuara janë shpenzuar 38,667,121 lekë.

Shpenzimet operative (602+603+604+606): **për vitin 2017** nga 5,277,961 lekë të planifikuara janë shpenzuar 4,963,825 lekë dhe **për vitin 2018** nga 7,754,569 lekë të planifikuara janë shpenzuar 7,740,569 lekë.

Faturat e palikuiduara për investime dhe shpenzime të ndryshme, në datën 31.12.2018 paraqiten në vlerën 82,085,867 lekë, krahasuar me gjendjen më 31.12.2017 janë ulur në vlerën 38,072,341 lekë ose krahasuar me gjendjen më 31.12.2016 janë rritur në vlerën 4,145,541 lekë.

Nga administrata e Bashkisë Klos nuk janë zhvilluar procedura të mjaftueshme për planifikimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

Kriteri:

- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 40 “E drejta për të kryer shpenzime”, neni 50 “Angazhimet buxhetore”, neni 52 “Kryerja e shpenzimeve”, neni 54 “Kryerja e pagesave”, neni 71 “Shkeljet dhe sanksionet”;
- Ligji nr. 48/2014 datë 24.04.2014, i ndryshuar me ligjin nr. 24/2015, datë 19.03.2015 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”;
- UMF nr. 5, datë 27.02.2014 i ndryshuar me udhëzimin nr. 5/1 datë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË
USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

- 21.05.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”;;
- UMF nr. 2, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”;
 - UMF nr. 1, datë 17.01.2019 “Për buxhetin e vitit 2019”, pikat 106-110, “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” dhe pikat 116-117, “Raportimi i detyrimeve të prapambetura në njësitë e qeverisjes vendore”;
 - UMF nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”.

Ndikimi/Efekti: Shlyerja e detyrimeve të prapambetura mundëson shlyerjen e detyrimeve që subjektet kanë ndaj punonjësve dhe nënkontraktorëve të tyre me të cilët kanë bashkëpunuar gjatë kryerjes së investimeve/ofrimit të shërbimeve. Gjithashtu, subjektet mund të shlyejnë edhe detyrimet e tjera të tyre, si ndaj furnitorëve, detyrimet fiskale, kredive të ndryshme, etj., gjë që është edhe një nga kushtet e përcaktuara në strategjinë e qeverisë për shlyerjen e këtyre detyrimeve. Shlyerja e detyrimeve të prapambetura ndikon edhe në parandalimin e kredive të këqija, rrit besimin në qeverisjen vendore dhe është thelbësor në mbarëvajtjen e shtetit dhe marrëdhënieve me tatimpaguesit dhe ajo që është më e rëndësishmja, pagesa e borxhit të krijuar në periudhat e kaluara është detyrim për shtetin, pavarësisht se kur janë krijuar ato. Rritja e vështirësive të biznesit për të shlyer detyrimet, nëpërmjet mospagimit të faturave nga shteti, sjell mungesa në plotësimin e nevojave reale të komunitetit dhe ulje të performancës së biznesit në drejtim të njësive vendore. Krijimi i tyre vështirëson punën e subjekteve nga mungesa e mjeteve financiare, humb besimin e subjekteve te institucionet shtetërore, i hap rrugë informalitetit, klientelizmit, korrupsionit, rrit shpenzimet gjyqësore, etj.

Shkaku: Mungesa e bashkërendimit të punëve dhe detyrave në Bashkinë Klos, paaftësia e menaxhimit të lartë për të vënë në funksionim strukturat financiare të bashkisë. Analizat e faturave të papaguara për mallrat, shërbimet dhe detyrimet e tjera të papaguara nuk janë bërë të plota në buxhetet paraardhëse, duke mos nxjerrë konkluzione të sakta për krijimin dhe akumulimin e detyrimeve të prapambetura.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Bashkia Klos (Sektori i Financës), bazuar në UMF nr. 2, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” dhe UMF nr. 1, datë 17.01.2019 “Për buxhetin e vitit 2019”, pikat 106-110, “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, pikat 116-11, 7 “Raportimi i detyrimeve të prapambetura në njësitë e qeverisjes vendore”, të paraqesë në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, një material për gjendjen e faturave të palikuiduara në vite, të hartojë një grafik duke zbatuar radhën e pagesave sipas kohës së krijimit të tyre për vlerën 82,085,867 lekë.

Të respektojë radhën e financimit për procedurat e raportuara si të prapambetura dhe të zhvillojë procedura të mjaftueshme për planifikimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

Afati

Personat

Menjëhërë

I.H., B.Ç., F.K.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

Përgjegjës:

Gjetje nr. 5 Probleme në procedurat e arkëtimit të taksave, tarifave vendore dhe kamatëvonesave përkatëse, si dhe në krijimin e regjistrave të subjekteve.

Situata:

Ka diferenca të konsiderueshme në arkëtimin e detyrimeve tatimore për bizneset dhe familjarët, në lidhje me taksat dhe tarifavat vendore dhe për llogaritjen e kontabilizimit e kamatëvonesave.

Në Bashkinë Klos ka një sasi të madhe debitorësh nga biznesi, (pothuajse i njëjti numër me bizneset aktive, pasi një pjesë e bizneseve debitore nuk janë me status aktiv).

1. Vlera totale e debisë për taksën e tokës është **5,477,706 lekë** (nga këto janë kontabilizuar 2,976,662 lekë), pjesa tjetër është e pa kontabilizuar pasi këtu është përfshirë edhe vlera 2,471,044 debi gjendje 30.09.2019 për detyrimet e vitit 2019.

2. Vlera totale e debisë për taksat e tarifavat të familjarëve është **13,766,523 lekë** (nga këto janë kontabilizuar 9,303,640 lekë), pjesa tjetër është e pa kontabilizuar pasi këtu është përfshirë edhe vlera 4,462,883 debi gjendje 30.09.2019 për detyrimet e vitit 2019).

3. Vlera totale e debisë për bizneset (detyrim+kamatë) është **23,861,427 lekë**, (2011-2016 (vlera 11,697,917 lekë e kontabilizuar pa kamatëvonesën 1,895,063 lekë) + 2017 (vlera 2,124,448 lekë e kontabilizuar pa kamatëvonesën 344,161 lekë) + 2018 (vlera 1,567,319 lekë e kontabilizuar pa kamatëvonesën 253,906 lekë) + 2019 (vlera 2,493,129 lekë e pakontabilizuar, pasi detyrimi e ka afatin deri me datë 31.12.2019). Në total kontabilizuar vitet 2011-2018 me vlerë në 15,389,684 lekë, dhe pa kontabilizuar shuma 2019 + kamatëvonesat 2011-2018 në vlerën 8,471,743 lekë, përkatësisht kamatëvonesat në vlerën 2,493,129 lekë dhe viti 2019 me vlerë në 5,978,614 lekë.

4. Detyrimi prej **37,627,950 lekë** (taksat e tarifavat të familjarëve 13,766,523 lekë + debia për bizneset (detyrim+kamatë) 23,861,427 lekë) përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Klos, kontabilizuar 24,693,324 lekë dhe pa kontabilizuar shuma pa kontabilizuar shuma 12,934,626 lekë.

5. Detyrimi prej **4,300,000 lekë** nga subjektet që tregtojnë karburante përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Klos.

6. Detyrimi prej **615,773 lekë** nga taksa për ndikimin në infrastrukturë nga objektet e legalizuara, përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Klos.

Nga Sektori i të Ardhurave të Bashkisë Klos, nuk janë marrë masa për arkëtimin e detyrimeve debitorë, duke ribërë njoftim vlerësimet tatimore vendore për të gjithë subjektet debitorë. Nuk janë zbatuar masa shtrënguese, me qëllim arkëtimin e detyrimeve tatimore.

Sektori i të Ardhurave Vendore nuk ka dërguar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, asnjë kërkesë për të vendosur Barrë Sigurie mbi titujt e pronësisë për mjetet dhe pasuritë e paluajtshme, sipas nenit 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

- e Shqipërisë”.*
- Kriteri:**
- Ligji nr. 8485, datë 12.5.1999 “*Kodi i Procedurave Administrative*”, i ndryshuar
 - Ligji nr. 9367, datë 07.04.2005 “*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*”;
 - Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “*Për Sistemin e Taksave Vendore*”, i ndryshuar;
 - Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008, “*Për Procedurat Tatimore*”, i ndryshuar;
 - Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “*Për Taksat Kombëtare*”, i ndryshuar;
 - Ligji nr. 33-2017, “*Për pagesën dhe fshirjen/shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshme në doganë, si dhe procedurën e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes/shuarjes së detyrimeve tatimore*”;
 - Ligji nr. 68-2017, “*Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore*”;
 - VKM nr. 783, datë 10.11.2011 “*Për procedurat e ndarjes së të ardhurave të taksës vjetore të mjeteve të përdorura me NJQV-të*”;
 - VKM nr. 7, datë 4.01.2012 “*Për përcaktimin e procedurave dhe të dokumentacionit të nevojshëm për arkëtimin e taksës së rentës minerare*” i ndryshuar;
 - UMF nr. 12, datë 4.4.2017 dhe Nr. 26, datë 04.09.2008, “*Për Taksat Kombëtare*”;
- Ndikimi/Efekti:** Mos pasqyrim i drejtë i situatës financiare të Bashkisë Klos, mangësi në realizimin e të ardhurave të programuara sipas paketës fiskale dhe rrjedhimisht mos përmbushje e programeve buxhetore në lidhje me realizimin e tyre, duke mos ofruar të gjitha shërbimet e nevojshme për popullatën. Akumulim i borxheve dhe rrjedhimisht pamundësi për të programuar në mënyrë të qartë dhe të realizueshme shpenzimet e buxhetit.
- Humbje e besimit të bizneseve dhe komunitetit të institucionet, duke parë që menaxhimi planifikon me shifra të fryra dhe të përealizueshme dhe nuk arrin të përmbushë angazhivet e veta dhe detyrimet ligjore.
- Shkaku:** Mos ndjekja dhe mos arkëtimi i detyrimeve të debitorëve nga Sektori i të Ardhurave.
- Mungesa e bashkëpunimit me institucionet, mungesa e përgjegjshmërisë dhe puna e pamjaftueshme e menaxhimit dhe punonjësve në terren, duke krijuar mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Klos dhe duke shkaktuar evazion fiskal.
- Mungesa e profesionalizmit të nivelit menaxhues dhe punonjësve, punësimi në bazë të interesave dhe jo në bazë të aftësive profesionale.
- Rëndësia:** E lartë
- Rekomandime:** 1. Bashkia Klos, të verifikojë gjendjen në kontabilitet dhe mënyrën e kontabilizimit të detyrimit në ngarkim të subjekteve debitorë për taksat dhe tarifatat vendore dhe familjeve debitorë për taksën e tokës dhe të ndërtesës, të kontabilizojë pjesën e pakontabilizuar të këtyre detyrimeve dhe të kërkojë sipas ligjit, arkëtimin e vlerave debitorë nga personat përkatës juridikë ose fizikë dhe familjarët, duke zbatuar sipas rastit edhe masat shtrënguese në zbatim të Kreut XI “*Mbledhja me forcë e detyrimit*”



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

tatimor të papaguar” të Ligjit nr. 9920, dt. 19.5.2008, “*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar për:

- Detyrimet për taksën e tokës në vlerën **5,477,706 lekë**.
- Detyrimet në vlerën **13,766,523 lekë** për taksat dhe tarifat të familjarëve.
- Vlera totale e debisë për bizneset (detyrim+kamatë) është **23,861,427 lekë**, (2011-2016 (vlera 11,697,917 lekë e kontabilizuar pa kamatëvonesën 1,895,063 lekë) + 2017 (vlera 2,124,448 lekë e kontabilizuar pa kamatëvonesën 344,161 lekë) + 2018 (vlera 1,567,319 lekë e kontabilizuar pa kamatëvonesën 253,906 lekë) + 2019 (vlera 2,493,129 lekë e pakontabilizuar, pasi detyrimi e ka afatin deri me datë 31.12.2019). Në total kontabilizuar vitet 2011-2018 me vlerë në 15,389,684 lekë, dhe pa kontabilizuar shuma 2019 + kamatëvonesat 2011-2018 në vlerën 8,471,743 lekë, përkatësisht kamatëvonesat në vlerën 2,493,129 lekë dhe viti 2019 me vlerë në 5,978,614 lekë.
- Detyrimi prej **615,773 lekë** nga taksa për ndikimin në infrastrukturë nga objektet e legalizuara, përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Klos.

Afati

Menjëherë

Gjetje nr. 6 Diferenca të konstatuara nga akt-rakordimet për vjeljen e të ardhurave nëpërmjet agjentëve tatimorë. Mangësi në bazën e të dhënave për agjentët tatimorë.

Situata: Ka mangësi në kryerjen e aktrakordimeve me institucionet përkatëse dhe diferencë të madhe në të ardhurat e planifikuara nga agjentët tatimorë me realizimin, kryesisht me ish ZVRPP-në për taksën e kalimit të pronësisë dhe DSHTRR-në për taksën vjetore të mjeteve të përdorura.

Bashkia Klos nuk ka krijuar baza të plota të dhënash për detyrimet që vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, në bazë të të cilave të bëjë akt-rakordimet.

Mungesë e marrëdhënieve dhe korrespondencës me institucionet e tjera, shtetërore apo private, me qëllim evidentimin dhe mbledhjen e të ardhurave tatimore dhe tarifore.

Kriteri:

- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “*Për sistemin e taksave vendore*” të ndryshuar;
- Ligji nr. 68-2017, “*Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore*”;
- Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”;
- Ligji nr. 9920, dt. 19.5.2008, “*Për Procedurat Tatimore*”;
- UMF nr. 26, dt. 04.09.2008 dhe UMF Nr. 12, dt. 4.4.2017, “*Për Taksat Kombëtare*”, etj.

Ndikimi/Efekti: Bashkia Klos nuk ka informacion të saktë dhe të plotë për gjendjen e saj financiare, për pritshmërinë nga të ardhurat që duhet të sigurohen nga agjentët tatimorë dhe rrjedhimisht nuk mund të bëjë në mënyrën e duhur dhe të plotë parashikimet buxhetore.

Shkaku: Mos krijimi i bazave të të dhënave, mosfunksionimi i strukturave të bashkisë dhe paqartësia e personelit në lidhje me bazën ligjore të posaçme për këto kategori të ardhurash.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Bashkia Klos, të marrë masa për evidentimin e diferencave të pambledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për gjatë të këtyre agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pambledhura apo të shmangura, sipas përcaktimeve në nenin 117 të Ligjit 9920, dt. 19.5.2008, “*Për Procedurat Tatimore*”, ku parashikohet se “*Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave*”, ku përcaktohet se: “*Agjenti i mbajtjes së tatimit në burim, agjenti i taksave apo tarifave, që nuk arrin të mbajë, të llogarisë, të raportojë dhe të transferojë në Buxhetin e Shtetit tatimin në burim apo tatimet, taksat dhe tarifatat e mbledhura, apo i shmangët mbledhjes së tyre, detyrohet të paguajë gjobë të barabartë me 50 për qind të shumës së plotë të tatimit, taksës apo tarifës së pambledhura apo të shmangur.*” Të marrë masa për të krijuar bazat e të dhënave për subjektet, tarifatat apo taksat e të cilave mblidhen nëpërmjet agjentëve tatimorë, të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministri i Financave.

Afati
Personat
përgjegjes

Menjëherë
Y.T., S.D.

Gjetje nr. 7 Mangësi në administrimin e pasurive publike, të mjedisit, të ardhurave të mundshme nga veprimtaria e subjekteve private në territorin e Bashkisë Klos.

Situata: Për asetet në pronësi të bashkisë, nga auditimi u konstatua se ka mangësi në lidhje me përditësimin e sipërfaqes faktike në dispozicion dhe asaj të regjistruar në ZVRPP (nëse ka) apo në listat e transferimit të pasurive nga KM. Kjo nuk është pasqyruar në inventarin e pasurive të paluajtshme dhe i ka hapur rrugë informalitetit. Gjithashtu, deri në periudhën objekt auditimi, shumë pak nga objektet e dhëna me qera figurojnë të regjistruara në ZVRPP, pra në pak raste Bashkia Klos disponon Tituj (Çertifikata) Pronësie për objektet apo tokat e kontraktuara.

Nga informacioni i vënë në dispozicion, u konstatua se nga kompanitë të cilat bëjnë investime strategjike në territorin e Bashkisë Klos, nuk është bërë asnjë procedurë për kontraktimin e sipërfaqeve në përdorim të tyre. Konkretisht, subjekti “G...”, i cili ndërton me PPP “Rrugën e Arbrit”, ka ngritur disa kantiere dhe kapanone në territorin e Bashkisë Klos, përdor territorin e Bashkisë Klos për depozitimin e mbetjeve dhe inerteve të nxjerra gjatë gërmimeve, përdor mineralin e nxjerrë nga territori i Bashkisë Klos, përfshirë mineralin e nxjerrë nga tunelet pa pasur një kontratë, marrëveshje apo autorizim me Bashkinë Klos, sipas ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 “*Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, neni 21 “*Shfrytëzimi i grupit të mineraleve ndërtimore*” pika 2-a), në të cilën parashikohet se: “2. Përjashtimisht, shfrytëzimi i grupit të mineraleve ndërtimore është i lirë, në rastet kur: a)



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

autoritetet vendore dhe qendrore ose persona të tjerë të autorizuar prej tyre, të përfshira në ndërtimin e rrugëve publike ose në ndërtime të tjera publike, përdorin mbeturinat nga gërmimet e nevojshme;”.

Përveç sa më sipër, ky subjekt duhet të lidhë edhe marrëveshjet përkatëse për shpyllëzimin dhe pyllëzimin e sipërfaqeve të cilat do të përdoren për ndërtimin e rrugës, etj.

Ky subjekt nuk është pajisur me NUIS sekondar për aktivitetin që ushtron në territorin e Bashkisë Klos dhe nuk paguan taksat dhe tarifatat vendore.

Kriteri:

- Ligji nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për Pronat e Paluajtshme të Shtetit”;
- Ligji nr. 9385, datë 04.05.2005, “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- VKM nr. 7, datë 4.01.2012 “Për përcaktimin e procedurave dhe të dokumentacionit të nevojshëm për arkëtimin e taksës së rentës minerare” i ndryshuar;
- UMF nr. 12, datë 4.4.2017, “Për Taksat Kombëtare”;
- Aktit të Ministrisë së Financave, nr. 16365 Prot., datë 17.10.2012, “Miratimi i vlerave referuese sipas normativave teknologjike të produkteve që përdorin minerale nga Komisioni AD-HOC mbi Rentën Minerale”.

Ndikimi/Efekti:

Bashkia Klos nuk ka informacion të saktë dhe të plotë për subjektet që ushtrojnë veprimtari në territorin e saj, gjë që shkakton mosrealizimin e të ardhurave dhe të shpenzimeve buxhetore, si dhe dëmtimin e pasurive dhe të mjedisit të saj nga subjekte të ndryshëm.

Mosrealizim i të ardhurave vendore nga taksat dhe tarifatat, rrjedhimisht më pak shërbime dhe kujdes për komunitetin.

Shkaku:

Bashkia Klos nuk ka menxhuar si duhet pasuritë e saj natyrore, duke i neglizhuar dhe duke i lënë t’i përdorin pa përfitim dhe pa asnjë marrëveshje, madje pa vjelë edhe taksat dhe tarifatat vendore subjekteve të ndryshme që ushtrojnë veprimtari në territorin e saj.

Rëndësia:

E lartë

Rekomandim:

1. Bashkia Klos të marrë masa për të verifikuar situatën në terren me subjektet që ushtrojnë veprimtari ndërtimore/minerare, etj. në territorin e saj, t’i autorizojë ose të lidhë kontrata apo aktmarrëveshje për t’i lejuar përdorimin sipas ligjit të materialeve/mineraleve të përfituara nga gërmimet ose në të kundërt të fillojë procedurat për vjeljen e rentës minerare.
2. Bashkia Klos të lidhë marrëveshje/kontrata me kompanitë ndërtuese të rrugëve, si për vendet ku këto kompani depozitojnë dherat teknologjikë, ashtu edhe për sipërfaqet që do të shpyllëzohen apo përdoren për ndërtimin e kapanoneve, kantierëve, etj.
3. Bashkia Klos, të kontabilizojë detyrimet dhe kamatëvonesat e subjekteve ndërtues që nuk kanë paguar taksat dhe tarifatat vendore, duke filluar që nga momenti i fillimit të veprimtarisë së tyre në territorin e saj dhe të ndjekë në vazhdimësi pagesat e detyrimeve vendore nga këto subjekte me veprimtari të përkohshme në territorin e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

saj.

Afati

Personat
përgjegjes

Y.T., S.D.

Gjetje nr. 8 Mos evidentim i subjekteve me veprimtari tregtare speciale, mos aplikim në formën dhe në vlerën e duhur i tarifave për këto kategori subjektsh.

Situata:

Gjatë auditimit të tarifave vendore për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, u konstatua se ka mangësi në plotësimin e të dhënave të këtyre subjekteve në përgjithësi dhe debitorëve në veçanti, si p.sh., në krijimin e një regjistri të posaçëm për këto lloj subjektsh, në evidentimin e subjekteve që e ushtrojnë këtë lloj aktiviteti dhe në mbledhjen e detyrimeve specifike për këto kategori biznesi. Nga auditimi i kësaj kategorie të bizneseve, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua se nga ish-komunat dhe ish-bashkia, si para konsolidimit, ashtu edhe pas konsolidimit, vazhdimisht është aplikuar në mënyrë të gabuar tarifa për pajisjen me leje tregtimi për karburantet. Konkretisht, në VKM-në Nr. 344, datë 19.04.2017, e cila ka ndryshuar VKM-në Nr. 970, datë 2.12.2015, parashikohet se: “9. *Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3,000,000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1,000,000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera.*”... “10. *Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, është 500,000 (pesëqind mijë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 100,000 (njëqind mijë) lekë për bashkitë e tjera.*”. Sipas këtyre detyrimeve ligjore, të gjitha subjekteve që ju ka mbaruar afati 5 vjeçar i autorizimit pas datës të hyrjes në fuqi të VKM-së nr. 970, datë 2.12.2015, për rinovimin e liçencës duhet të paguajnë si më sipër. Në shumicën e rasteve tarifa e pajisjes me autorizim për tregtimin e hidrokarbureve është llogaritur gabim. Kjo përbën të ardhur të munguar për Buxhetin e Bashkisë Klos, në vlerën **4,300,000 lekë**.

Kriteri:

- Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;
- Ligji Nr. 9920, dt. 19.5.2008, “Për Procedurat Tatimore”;
- VKM nr. 170, dt. 25.04.2002, nr. 344, dt. 19.4.2017 dhe nr. 970, dt. 02.12.2015 “Për Liçencat e tregtimit të Hidrokarbureve”;
- UMF nr. 26, Dt. 04.09.2008 dhe nr. 12, dt. 4.4.2017, “Për Taksat Kombëtare”, etj.

Ndikimi/Efekti:

Bashkia Klos nuk ka informacion të saktë dhe të plotë për subjektet që ushtrojnë veprimtari në territorin e saj, gjë që shkakton mosrealizimin e të ardhurave dhe të shpenzimeve buxhetore.

Një pjesë e bizneseve që tregtojnë produkte të hidrokarbureve nuk i përmbushin detyrimet për sigurinë dhe kjo përbën rrezik serioz për jetën e njerëzve etj.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

Mosrealizim i të ardhurave vendore nga taksat dhe tarifat, rrjedhimisht më pak shërbime dhe kujdes për komunitetin.

Shkaku:

Neglizhenca për vjeljen e të ardhurave vendore, pamundësia për të verifikuar dhe mbajtur në kontroll sigurinë minimale të domosdoshme për tregtimin e karburanteve dhe lëndëve djegëse.

Rëndësia:

E lartë

Rekomandime:

Bashkia Klos të marrë masa për të kontabilizuar detyrimin dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **4,300,000 lekë**, (sipas detajimeve në anekset bashkëlidhur), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit ndaj debitorëve. Gjithashtu, të verifikojë nëse ka subjekte të tjera të cilat në QKB figurojnë aktivë dhe me objekt aktiviteti tregtinë e karburanteve apo lëndëve djegëse për popullatën të cilat zhvillojnë këtë lloj aktiviteti dhe të liçencohen apo të pezullohen, sipas rastit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

C. VLERËSIMI I RAPORTIMIT FINANCIAR, BAZUAR NË KUADRIN RREGULLATOR NË FUQI.

1.1 Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike;

1.2 Vlerësimi i arsyeshëm e i bazuar (në rastet kur vlerësimet janë të domosdoshme) ;

1.3 Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të nënnyesisë;

1.4 Opinioni mbi pasqyrat financiare;

Nga verifikimi formal i pasqyrave financiare për vitin 2018 rezultoi se janë: - pasqyra e pozicionit financiar, - pasqyra e performancës financiare, - pasqyra e flukseve monetare, - pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto, - investimet dhe burimet e financimit, - gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata, - numri i punonjësve dhe fondi i pagave.

Hartimi i pasqyrave financiare bazohet në konceptet dhe rregullat e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK 2 “*Paraqitja e Pasqyrave Financiare*”), të përcaktuara në Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004, “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*”.

Në mbështetje të nenit 3 dhe 6 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 6 të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 për “Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, nenit 10 dhe 11 të Ligjit nr.9228 datë 29.04.2004 “*Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare*”.

Nuk ka patur komunikim me MFE për aspekte të trajtimeve kontabile, apo mbyllje vjetore.

Udhëzimi nr.14 datë 28.12.2006 “*Për Institucionet Qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë në varësi*”.

Udhëzimi i MF nr.26 datë 27.12.2007 për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e MF nr.14 datë 28.12.2006.

Udhëzimi i MF nr.8 datë 09.03.2019 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të qeverisjes së përgjithshme*”.

Bilanci kontabël:

Bilanci i hartuar paraqet informacionin mbi pozicionin financiar të Bashkisë Klos në fund të periudhës kontabël dt. 31.12.2018.

Bilanci kontabël është ndërtuar nga tre pjesë:

- *Aktivitet, Detyrimet, Kapitali.*

Klasifikimi i elementeve të mësipërme në nëngrupe dhe paraqitja e bilancit është bërë bazuar në parimin e materialitetit për të siguruar pamjen e vërtetë dhe të sinqertë të situatës financiare.

Kjo situatë financiare në bilancin kontabël paraqitet e krahasuar me atë të periudhës paraardhëse dhe përmban kolonat me shumat për periudhat përkatëse .

Në hartimin e bilancit është zgjedhur që nënnyerat e bilancit të paraqiten drejtpërdrejt në pasqyrën e bilancit.

Gjetjet më kryesore që u konstatuan në auditimin e pasqyrave financiare dhe në pozicionet e llogarive të përmbledhura paraqiten për sa vijon:

Gjetje nr.9 **Problematikat në inventarizimin e pronës shtetërore llog.210 “Toka, Troje, Terrene” dhe llogarisë 211”Pyje, Plantacione dhe Kullota”.**

Situata

Aktivitet të cilat janë detajuar me regjistra kontabël (llogaria 210 “*Toka, troje e terrene*”, llogaria 211 “*Pyje, Plantacione dhe Kullota*”) nuk përmbushin kriteret e paraqitjes së formatit si dhe nuk janë azhornuar pas bashkimit të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

njësive administrative duke dhënë një pamje jo të plotë për këto regjistra. Sektori i financës Bashkia Klos për asnjë periudhë raportuese objekt auditimi (2017-2018), nuk ka kërkuar dhe bërë rivlerësim të pasurisë, asetëve dhe aktiveve të transferuara me VKM në kuadër të reformës territoriale me çmimin referues, si dhe nuk janë pasqyruar në aktivet e qëndrueshme të trupëzuara në pasqyrat financiare për secilën periudhë raportuese konkretisht:
-llog.(210)“*Toka, troje, terrene*” vlera kontabël 999,520 lekë e pa ndryshuar.
-llog.(211)“*Pyje, kullota, plantacione*” vlera kontabël 0 lekë e pa ndryshuar.
Sektori i Financës dhe kontabilitetit për këto asetet nuk disponon regjistra, kartela llogarie dhe dokumentet kontabël me të dhëna të domosdoshme mbi objektet me qëllim të evidentohen të dhënat e nevojshme si (*viti krijimit të asetit, amortizimi në vite, planimetria dhe projekti objektit ndërtimor, etj.*)

Kriteri:	Ligjin 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare “ neni 7 , udhëzimi nr.30 datë 27.12.2011 “ <i>Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik</i> ” sipas pikës 73, 97, 99, 100, 102, 105 të udhëzimit 30 datë 27.12.2011.
Impakti:	Në kontabilitet për këto asetet nuk disponon regjistra, kartela llogarie dhe dokumentet kontabël me të dhëna të domosdoshme mbi objektet me qëllim të evidentohen të dhënat e nevojshme si (<i>viti krijimit të asetit, amortizimi në vite, planimetria dhe projekti objektit ndërtimor, etj</i>), asete të cilat nuk janë regjistruar në ZRPP Mat në pronësi të njësisë publike Bashkia Klos.
Shkaku:	Mos njohja dhe mos zbatim i Ligjit 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 7 dhe pikën 105 të udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 “ <i>Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik</i> ” sipas pikës 73, 97, 99, 100, 102, 105 të udhëzimit 30 datë 27.12.2011.
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandimi:	Nga ana e Bashkisë Klos të merren masa për të azhurnuar regjistrat kontabël me informacion të plotë pas bashkimit me njësitë administrative duke plotësuar kërkesat e formatit të paraqitjes së tyre, të përpilohet lista e aktiveve të identifikuar për vlerësim dhe inventarizim. Titullari i njësisë publike Bashkia Klos të ngrejë një grup pune me specialist përkatës, për evidentimin e asetëve dhe pasurisë të kaluara me VKM në pronësi të Bashkisë, ndërsa nga Sektori i Financës, të merren masa me qëllim të saktësohet gjendja fizike dhe kontabël e llog.(210); llog.(211) me qëllim pajisjen me dokumentet e nevojshme tekniko-ligjore për të regjistruar secilin objekt në ZRPP në pronësi të Bashkisë Klos, si dhe pasqyrimin me dokumente ligjore të gjendjes së këtyre asetëve.

Gjetje nr.10 Për llogarinë 213, “*Rrugë rrjete vepra ujore*” për vitin 2018 për vlerën totale prej 72,233,482 lekë, transaksionet dhe ngjarjet nuk janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël.

Nga auditimi konstatohet se:
1.Për investimin me objekt “Ndërtim i Bypass-it të Qytetit të Klosit”
kontrata është lidhur në vitin 2017 me vlerën e plotë prej 117,389,925 lekë, edhe pse akti i marrjes në dorëzim është në datën 08.08.2018 nga vlera totale e investimit prej 117,389,925 lekë, vlera prej 71,225,083 lekë është pasqyruar në bilancin e vitit 2017, ndërsa vlera prej 47,104,802 lekë

Situata



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

është paraqitur në bilancin e vitit 2018. Nga ana e Sektorit të Financës së Bashkisë Klos e gjithë vlera e investimit prej 117,389,925 lekë duhet të ishte paraqitur ne bilancin e vitit 2018, pra në momentin e marrjes në dorëzim të veprës.

Për vlerën 71,225,083 lekë, e cila nuk është pasqyruar në bilancin e vitit 2018, ndërkohë që i gjithë investimi ka përfunduar në vitin 2018, transaksionet dhe ngjarjet nuk janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël.

2.Për investimin me objekt “Ndërtim i Kanalit Suc” kontrata është lidhur në vitin 2017 me vlerën e plotë prej 1,391,016 lekë, edhe pse akti i marrjes në dorëzim është në vitin 2018 nga vlera totale e investimit prej 1,391,016 lekë, vlera prej 500,000 lekë është pasqyruar në bilancin e vitit 2017, ndërsa vlera prej 891,016 lekë është paraqitur në bilancin e vitit 2018. Nga ana e Sektorit të Financës së Bashkisë Klos e gjithë vlera e investimit prej 1,391,016 lekë duhet të ishte paraqitur ne bilancin e vitit 2018, pra në momentin e marrjes në dorëzim të veprës.

Për vlerën 500,000 lekë, e cila nuk është pasqyruar në bilancin e vitit 2018, ndërkohë që i gjithë investimi ka përfunduar në vitin 2018, transaksionet dhe ngjarjet nuk janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël.

3.Për investimin me objekt “Ndërtim i aksit Unjate-Mishter” kontrata është lidhur në vitin 2017 me vlerën e plotë prej 2,153,631 lekë, edhe pse akti i marrjes në dorëzim është në vitin 2018 nga vlera totale e investimit prej 2,153,631 lekë, vlera prej 508,399 lekë është pasqyruar në bilancin e vitit 2017, ndërsa vlera prej 1,645,232 lekë është paraqitur në bilancin e vitit 2018. Nga ana e Sektorit të Financës së Bashkisë Klos e gjithë vlera e investimit prej 2,153,631 lekë duhet të ishte paraqitur ne bilancin e vitit 2018, pra në momentin e marrjes në dorëzim të veprës.

Për vlerën 508,399 lekë, e cila nuk është pasqyruar në bilancin e vitit 2018, ndërkohë që i gjithë investimi ka përfunduar në vitin 2018, transaksionet dhe ngjarjet nuk janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël.

Urdhri i Ministrisë së Financave nr.14 datë.28.12.2006, “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore te vitit 2006 per institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe të njësive të menaxhimit / zbatimit të projekteve dhe marrëveshjeve me donatorë të huaj”; Ligji nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, nenin 7, 9, 10; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Regjistrim i gabuar në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në bilanc të llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën prej 72,233,482 lekë për vitin 2018.

Kriteri

Impakti:

Shkaku:

Rëndësia:

Rekomandimi:

I lartë.

-Sektori i financës në të gjitha regjistrimet kontabël, të veprojë sipas parimit të konstatimit: të gjitha shpenzimet të pasqyrohen në kontabilitet dhe në pasqyrat financiare, atëherë kur ato ndodhin dhe jo kur kryhet pagesa. Raportimi i tyre në pasqyrat financiare të bëhet në atë periudhë kontabël së



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

cilës i përkasin shpenzimet. Nga titullari të merren masa për regjistrimin e asetëve të llogarisë 213 në ZRPP dhe kontabilitet.

Gjetje nr.11 Gjendja e faturave të palikujduara në fund të periudhës 2018, dhe mos deklarimi në fund të periudhës ushtrimore të vitit 2018, të faturave të palikujduara në llogarinë 401-408 dhe 467, fatura të cilat janë likuiduar gjatë vitit 2019, konstatuar kjo nga testet e kryera në likuidimin të këtyre periudhave.

Situata: Për aktivitetin e vitit 2018, konstatohet se totali i faturave të palikujduara në fund të vitit 2018 në Llog (401-408) “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, paraqitet në vlerën **16,936,547** lekë ndërsa llog (467) “Kreditorë të ndryshëm”, paraqitet në vlerën **65,149,320** lekë. Arsyeja e mos likuidimit të këtyre faturave është nga mos realizimi i të ardhurave, mungesa e lëvrimin të fondeve dhe bllokimit të fondeve nga Ministria e Financave në fund të periudhës ushtrimore.

Në testet e kryera bazuar tek të dhënat e sistemit “SIFQ” mbi faturat e likuiduara në periudhën Janar – Gusht 2019, për llogari të vitit 2018 dhe përpara, u konstatua se:

-Urdhër shpenzimi me nr.459 datë 15.04.2019 me objekt “Shpenzime për konstruksione të rrugëve” me OE fitues “C...” është likuiduar me vlerën prej **4,450,025** lekë, rezulton se kontrata me nr.2560 datë 04.10.2018 është lidhur gjatë vitit 2018 dhe fatura tatimore ka nr.499 dhe paraqet datën 31.10.2018. Pra vlera prej **4,450,025** lekë paraqet një detyrim të lindur gjatë vitit 2018 dhe duhet të ishte e paraqitur në pasivin e bilancit të vitit 2018 në llog.467 “Kreditorë të ndryshëm”, gjë e cila nuk rezulton të jetë e përfshirë në analitikun e paraqitur nga Bashkia Klos.

-Urdhër shpenzimi me nr.208 datë 21.02.2019 me objekt “Skica kadastrale për regjistrim pasurie (plan rilevimi)” me OE fitues “D...” është likuiduar me vlerën prej **38,000** lekë, rezulton se kontrata me nr.260 datë 11.09.2018 është lidhur gjatë vitit 2018 dhe fatura tatimore ka nr.260 dhe paraqet datën 08.10.2018. Pra vlera prej **38,000** lekë paraqet një detyrim të lindur gjatë vitit 2018 dhe duhet të ishte e paraqitur në pasivin e bilancit të vitit 2018 në llog.467 “Kreditorë të ndryshëm”, gjë e cila nuk rezulton të jetë e përfshirë në analitikun e paraqitur nga Bashkia Klos.

Llog.467 “Kreditorë të ndryshëm” të Bilancit Kontabël në vitin 2018 të vlerës së detyrimeve të prapambetura të cilat duhet të jenë me vlerë kontabël **69,637,345** lekë dhe jo **65,149,320** lekë.

Kjo llogari duhet të rakordohet me llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” me të njëjtën vlerë prej **69,637,345** lekë.

Kjo procedurë mospasqyrimi në Llog.467 “Kreditorë të ndryshëm” të Bilancit Kontabël të vlerës së detyrimeve të prapambetura të cilat janë me vlerë kontabël **69,637,345** lekë është në kundërshtim me nenin nr.3.3 të Udhëzimit të Mnishtisë së Financave nr.8 datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore”.

Mangësitë e mësipërme (mos regjistrim i faturave kreditore), në fund të periudhës ushtrimore si detyrime që Bashkia Klos ka ndaj subjekteve të ndryshme, bën që pasqyrat financiare të mos paraqesin realitetin e tyre.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

Kriteri: Me nenin 52- *Kryerja e shpenzimeve*, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 ”Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; nenin 9 dhe 10, të ligjit nr. 9928, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar; UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” i ndryshuar me UMF nr.5/1, datë 21.05.2014; Udhëzimin udhëzimi plotësues i MF nr. 02, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 – *Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore*; VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, pjesa e parë, “*Rregulla të përgjithshme*” kapitulli i parë “*Mbajtja e kontabilitetit*”; UMF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe të njësive që varen prej tyre”, ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007, “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të institucioneve qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorët e huaj” dhe me nenin nr.3.3 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”.

Impakti: Pasqyrat financiare nuk paraqesin realitetin të veprimeve financiare, kjo nga mos pasqyrimi i të gjithë vlerës së faturave të palikjduara në fund të periudhës (kreditorët).

Shkaku: Mosveprim i nënpunësit zbatues. Analizat e faturave të papaguara për mallrat, shërbimet dhe detyrimet e tjera të papaguara nuk janë bërë të plota në buxhetet paraardhëse, duke mos nxjerrë konkluzione të sakta për krijimin dhe akumulimin e detyrimeve të prapambetura

Rëndësia: **I lartë.**

Rekomandimi: Sektori i Financës të paraqes një material ku të rakordojë me sistemin SIFQ gjendjen e faturave të pa likuiduara në vlerën **69,637,345** lekë, duke ndjekur radhën e pagesave.

Gjithashtu, të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave për likuidimin e faturave jashtë kontabilitetit, dhe për çdo rast faturat e palikujduara në fund të vitit ushtrimor të bëhet kontabilizimi i tyre, duke i paraqitur si detyrime në fund të periudhës ushtrimore.

Gjetje nr.12 Mangësi në pasqyrimin e investimeve në proces dhe llogarisë nr.105 “Teprica e Granteve kapitale të brendshme.

Situata

Nga auditimi u konstatua se: Teprica e Granteve kapitale të brendshme mbeten me tepricë në fund të periudhave ushtrimore vetëm në rastet kur këto grante janë burim për investimet në proces të institucioneve (të papërfunduara ose të pamarrë në dorëzim). Në aktiv të bilancit këto janë investime në proces në grupin e llogarive 23. Këto mbyllen (kapitalizohen) me fondet bazë në kohën kur investimi është përfunduar dhe marrë në dorëzim.

Nga ana e Bashkisë Klos vlera **1,817,640** lekë bëhet e ditur se paraqesin investime të përfunduara e cila bie në kundërshtim me pikën 1.1.2 Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.8 datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore” ku thuhet qartë që



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

Kriteri	duhet të ishin kapitalizuar me fondet bazë kur investimi është marrë në dorëzim. Pra llogaria 105 “Teprica e Granteve kapitale të brendshme” në këtë rast duhet të ishte në vlerën 0 lekë duke mos patur tepricë kreditore në fund të vitit.
Impakti:	Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr.8 datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore” <i>ku specifikohet trajtimi kontabël dhe funksionimi i AAGJ financiare</i> , Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”.
Shkaku:	Regjistrim i gabuar i investimeve në proces në llogarinë 105 “Teprica e Granteve kapitale të brendshme” duke pasqyruar në fund të vitit tepricë kreditore.
Rëndësia:	Mangësia në regjistrimin e investimeve të përfunduara dhe investimeve në proces gjatë vitit ushtrimor 2018.
Rekomandimi:	I mesëm. Nga Sektorit i Financës të Bashkisë Klos të merren masa për të bërë sistemimin në kontabilitet të investime të përfunduara në vlerën 1,817,640 lekë duke i debituar te llogaritë e grupit 23 (Investime) të aktiveve afatgjata dhe duke kredituar llog.105 “Teprica e Granteve kapitale të brendshme”.

Gjetje nr.13 Mos përputhja e vlerave të paraqitura për shpenzimet gjatë vitit 2018 në raportin e monitorimit të shpenzimeve me vlerat në pasqyrat financiare.

Situata	<p>Nga audtimi u konstatua se nga vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare janë të ndryshme nga vlerat e paraqitura në raportet e monitorimit “Shpenzimet korrente” sipas bilancit paraqiten në vlerën 399,909lekë/000 kurse sipas raportit të monitorimit vlera e tyre është 400,317 lekë/000 me diferencë -408 lekë/000. Llog. 600 “Paga e shpërblime të tjera personeli” në formatin nr. 3/1 “Shpenzime të ushtrimit” paraqitet në vlerën 99,102 lekë kurse në raportin e monitorimit vlera e kësaj llogarie është 110,514 lekë/000 me një diferencë prej -1,412 lekë/000. Llog. 601 “Kontribute Sigurime Shoqërore e shëndetësore” në formatin nr. 3/1 “Shpenzime të ushtrimit” paraqitet në vlerën 17,907 lekë/000 kurse në raportin e monitorimit 2018 vlera e kësaj llogarie është 17,867 lekë/000 me një diferencë prej 40 lekë/000. Llog. 602 “Mallra dhe shërbime të tjera” në formatin nr. 3/1 “Shpenzime të ushtrimit” paraqitet në vlerën 55,265 lekë/000 kurse në raportin e monitorimit 2018 vlera e kësaj llogarie është 65,400 lekë/000 më pak prej -10,135 lekë/000.</p> <p>Raportet e monitorimit të shpenzimeve për vitin 2018, që janë paraqitur në Ministrinë e Financave, ndër të tjera edhe për programin “Planifikim, menaxhim, administrim” të cilat nuk janë të plotësuar me një informacionin më të plotë me shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e PBA, buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel programi dhe artikulli, lidhur me ndryshimet e planit të produkteve, si në sasi dhe në vlerë në përputhje me Udhëzimet e Ministrit të Financave për zbatimin e buxhetit të shtetit. Mungojnë argumentet e plota në lidhje me mosrealizimin e produkteve dhe masat që parashikohen në të ardhmen për realizimin e tyre. Performanca e produkteve “Planifikim, menaxhim, administrim” nuk është e paraqitur e lidhur me realizimin e objektivave dhe politikës së programit ku të</p>
----------------	---



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

shpjegohej cilat ish-in objektivat sipas PBA, politikat e çdo programi si dhe sa janë realizuar këto objektiva.

- Të dhënat faktike të raportuara nga Bashkia Klos nuk janë në përputhje me shpenzimet e ushtrimit të paraqitura në formatin nr. 4 “Shpenzimet e ushtrimit”.

Kriteri

Me nenin 52- *Kryerja e shpenzimeve*, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 ”Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; nenin 9 dhe 10, të ligjit nr. 9928, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar; UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” i ndryshuar me UMF nr.5/1, datë 21.05.2014; Udhëzimin udhëzimi plotësues i MF nr. 02, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 – *Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore*; VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, pjesa e parë, “*Rregulla të përgjithshme*” kapitulli i parë “*Mbajtja e kontabilitetit*”; UMF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe të njësive që varen prej tyre”, ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007, “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të institucioneve qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorët e huaj” dhe me nenin nr.3.3 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”.

Impakti:

Mos përputhja e shpenzimeve të raportit të monitorimit të shpenzimeve me pasqyrat financiare të vitit 2018.

Shkaku:

Mos njohja dhe mos zbatim i Udhëzimit plotësues i Ministrisë së Financave nr. 2, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018; ”Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.8 datë 09.03.2018; Me nenin 52- *Kryerja e shpenzimeve*, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 ”Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; nenin 9 dhe 10, të ligjit nr. 9928, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar; UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” i ndryshuar me UMF nr.5/1, datë 21.05.2014.

Rëndësia:

I mesëm.

Rekomandimi:

Nga ana e Sektorit të Financës të Bashkisë Klos të merren masa për të bërë rakordimin dhe unifikimin e vlerave të paraqitura në pasqyrat financiare me vlerat e paraqitura në raportin e monitorimit të shpenzimeve. Raporti i Monitorimit për zbatimin e buxhetit, të përmbajë një informacion të plotë me shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e PBA, e buxhetit, nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel programi dhe artikulli, lidhur me ndryshimet e planit të produkteve, si në sasi dhe në vlerë.

Sa më sipër 5 gjetjet janë trajtuar më hollësisht në ANEKS C bashkëlidhur.

Gjetje nr.14: Mosrakordimin e gjëndjes fizike me gjëndjen kontabël të inventarit të magazinave për 9/mujorin 2019.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

Situata:	<p>Në Bashkinë Klos, nga auditimi <i>i aktiveve afatshkurtra dhe aktiveve afatgjata, llogaritë:</i> Llogaria 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione” Llogaria 213 “Rrugë, rrjete dhe vepra ujore” Llogaria 31 “Materiale” rezultoi se për 9 mujorin 2019, janë zhvilluar 9 blerje me vlerë të vogël apo të lartë, të cilat janë artikuj ndërtimi, që do të vihen në objekt nga ana e vetë Bashkisë (me punonjësit e Bashkisë). Për Aktivet sa më sipër, të bëra hyrje janë hartuar akt marrjet në dorëzim nga komisionet përkatëse të marrjes në dorëzim, të ngritura me urdhër të Titullarit të Bashkisë. Janë bërë hyrje në magazinë materiale ndërtimi në vlerën 13,460,245 lekë dhe janë bërë dalje materiale në vlerën 2,275,287 lekë. Për periudhën 9 mujori 2019, gjendja e kartelave të magazinës për to nuk rakordon me gjendjen fizike të materialeve të bëra hyrje, në shumën 11,184,958 lekë. Gjithashtu për këtë mos rakordim u konstatua se vlera prej 10,427,467 lekë është bërë hyrje, nuk është gjendje në magazinë, nuk është bërë dalje dhe nuk është likuiduar nga Bashkia Klos. Ndërsa shuma prej 2,665,812 lekë, është bërë hyrje në magazinë, nuk është bërë dalje, nuk është gjendje fizike dhe është likuiduar. Në përdorimin e këtyre materialeve nuk ka urdhër dorëzimi, fletëkërkesa, plan shpërndarje, nuk ka fletë dalje provizore, nuk ka preventiva dhe situacione për punën e kryer. Gjithashtu nisur nga fakti se këto janë materiale ndërtimi, të cilat nuk mund të magazinohen, nuk janë bërë dalje direkt sipas objekteve (pa kaluar në magazinë). Në lidhje me këto materiale nga auditimi rezultoi se ekzistojnë akt konstatime të mbajtura nga Sektori i Shërbimeve, në NJA Suç, Gurrë, Xibër dhe për qytetin Klos. Këto konfirmojnë tërheqjen përkatëse nga magazina dhe vënien në objekt të tyre. Autorizimet janë firmosur nga personi i autorizuar dhe nga përfaqësues të Sektorit të Shërbimeve, për: NJA Suç në 21 raste NJA Gurrë në 26 raste Klos në 22 raste NJA Xibër në 31 raste</p>
Kriteri	Udhëzimi i Ministrisë së Financave, nr.30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, dalë në zbatim të nenit 6, germa “e” të ligjit nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, kapitulli “ Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve ”, pikat 38, 39, 40, 41.
Impakti	Mos dokumentimi i daljes nga magazina, rritja e vlerës së gjendjes të materialeve në magazinë në shumën 11,184,958 lekë.
Shkaku	Mos zbatimi i kërkesave ligjore.
Rekomandimi:	Nga ana Bashkisë Klos të merren masa për ngritjen e një grupi pune, të përbërë nga Drejtoria e Urbanistikës, Drejtoria e Shërbimeve, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Sektori i Auditit të Brendshëm, me qëllim të verifikimit të materialeve të vëna në objekte (të cilësuar nëpër



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

aktkonstatimet përkatëse), rakordimit të tyre nëpërmjet hartimit të situacioneve, deri në kryerjen e veprimeve me magazinën dhe kontabilitetin.

Më hollësisht trajtuar në ANEKS C/I.

Sa më sipër janë paraqitur komente nga:

1- z. Abert Çollaku, me nr.1832/9, datë 22.10.2019, i cili komenton sa vijon:

“Unë ne asnjë rast nuk jam nëpunësi I autorizuar nga nëpunësi autorizues ,por ky udhëzim ngarkon me përgjegjësi Drejtorinë e Financave dhe jo mua.

Gjithashtu po te shikoni organigramën e Bashkisë Klos Drejtoria e Shërbimeve përbehet nga disa sektore dhe Sektori I shërbimeve I cili përbehet nga disa inspektor dhe ka një përgjegjës sektori I cili ka mbuluar dhe ka për detyre te justifikimit te mallarave ndërtimore.

Gjithashtu unë si Drejtor i Infrastrukturës qe ne vitin 2018 kam bere një Plan Pune mbi mënyrën e funksionimit te Sektorëve qe përfshin Drejtoria ime, ku kam dhe miratimin e titullarit te Bashkisë Klos. Kjo rregullore ka qene object pune dhe për vitin 2019. Ne këtë rregullore apo plan pune janë përcaktuar personat përgjegjës për justifikimin e mallrave dhe shërbimeve qe kryhen ne secilin sektor. Bashkëlidhur po ju dërgojmë dhe planin e punës.

Ju informoj se për te gjitha rastet për te cilat unë kam patur kërkesa verbale për përdorime te materialeve ndërtimore kam hartuar plan shpërndarjet dhe plotësuar dokumentacionin sipas ligjit. Një kopje origjinale e një dokumentacioni justifikues gjendet ne zyrën e financës te inspektori qe mbulon magazinën.

Për te gjitha produktet apo materialet për te cilat nuk jam autorizuar apo nuk kam patur dijeni nuk mund te beja plan shpërndarje. Presa ju përket hartimit te preventivave dhe situacioneve është sektori i Zhvillimit dhe Planifikimit te Territorit qe duhet ti hartoje. Ky sektor nuk ka patur varësi dhe nuk është pjese e Drejtorisë time. Ky sektor ka qene ne varësi te drejtpërdrejte nga kyetari i Bashkisë Klos.

Bazuar sa parashtrova me lart unë ne cilësinë e Drejtorit te Infrastrukturës dhe Shërbimeve ju kundërshtoj akt konstatimin tuaj e përgjegjësitë qe ju me keni ngarkuar. Pra ,ne asnjë rast ne te cilin ju relatoni ne akt kostatimin nr.4 unë nuk kam abuzuar apo me bën fajtor për materiale te cilat nuk janë ne magazine apo kane dale nga ajo.

Sa me sipër unë nuk kam asnjë nënshkrim apo gjurme auditimi qe te me pergjegjesoje . Personat përgjegjës I keni ne dokumentacionin qe ju keni audituar. derisa ish kryetari ky kryer veprime me mallrat ne magazine pa kaluar nga Drejtoria qe unë kam drejtuar, nuk kam asnjë përgjegjësi ligjore ,pasi ai ka qene nëpunësi I pare urdhërues. Njëkohësisht ju kërkoj takim ballafaques ,pasi me është mohuar një e drejte kushtetuese për tu dëgjuar ,pasi nuk me është dhëne mundësia për te shpjeguar për problemet qe keni trajtuar ,gjithashtu nuk me keni treguar apo paraqitur një dokument ne te cilin unë kam nënshkruar shkelje ligjore. Për këtë do ti drejtohem dhe Kryetarit te KLSH-se qe te me krijoje mundësinë e paraqitjes se gjithë observacionit tim ,ku ju me keni bere bashkëfajtor për materiale te cilat nuk kane lidhje me mua apo nënshkrime ne emër tim.

Sqarim: Ju sqarojmë se komenti juaj merret në konsideratë,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

D. Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.

1. Hartimi i programit (Plan veprimit) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve;
2. Realizimi i programit (Plan veprimi) dhe raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor;
3. Statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm;

Gjetja nr.15 Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimet e mëparshme.

Situata: Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve në mënyrë të përmbledhur zbatimi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 14 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 14 masa, nga të pranuarat janë zbatuar 6 masa dhe janë në proces zbatimi 6 masa organizative dhe ka 2 masa organizative të pa zbatuara.

b. Për shpërblim dëmi janë rekomanduar 19 masa me vlerë 93,876,457 lekë, deri me datë 30.09.2019, janë arkëtuar 2,403,429 leke, ndërsa shuma prej 81,419,908 lekë nuk është arkëtuar.

c. Për shpenzime në kundërshtim me principet e 3 -të është rekomanduar që të analizohet në një masë në vlerën 15,237,049 lekë, e pranuar dhe e zbatuar.

d. Janë rekomanduar 18 masa disiplinore, gjendja e të cilave paraqitet:
- Sipas “Ligjit për Nëpunësin Civil” është rekomanduar 8 masa disiplinore “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, neni 58 germa (c)” masa të cilat janë zbatuar te gjitha, me perjashtim te nje rasti, znj. H.T., e cila nuk eshte ne marredhenie pune me Bashkine Klos, per shkak te daljes ne pension.
Sipas “Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë” janë rekomanduar 10 masa disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”, për të cilën Kryetari i Bashkisë Klos ka nxjerrë urdhërat për masën disiplinore “Vërejtje” për 3 punonjës, dhe për masën disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna” për 7 punonjës.

e. I janë rekomanduar APP të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo me rekomandimin e autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore) për **12 persona**. Nga verifikimi rezulton se APP me vendimin nr. 91 datë 19/12/2017 percjellë për në Bashkinë Klos dhe KLSH-në me shkresën nr. 12502/3 datë 19.12.2017, e cila është protokolluar në Bashkinë Klos me shkresën nr. 2726 prot., datë 21.12.2017 duke vendosur masa dënim me gjobe për **9 persona** dhe rekomandim për masë disiplinore për **3 persona** (vetëm 7 persona janë në marrëdhënie pune pranë Bashkine Klos). Për të cilët nga Bashkia Klos janë njoftuar personat janë kontabilizuar veprimet, apo janë në proces gjyqësor me APP (sipas rastit)

Kriteri Shkresa nr.1005/76 datë 20.12.2018, e Kontrollit të Lartë të Shtetit për “Rikërkimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga kontrollet e mëparshme”.

Impakti Realizimi jo i plotë i të ardhurave.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË
USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

Shkaku	Moszbatimi i plotë i rekomandimeve të lëna.
Rëndësia:	I mesëm
Rekomandimi	Kryetari i Bashkisë Klos të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara të KLSH në auditimin e mëparshëm, si masa shpërblim dëmi dhe masa organizative.
Afati zbatim	për Menjëherë

Më hollësisht trajtuar në ANEKS E, bashkëlidhur.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

Në përfundim të trajtimit të çështjeve sa në sipër për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë:

A. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga auditimi: Në drejtim të vlerësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Bashkinë Klos, nga Grupi i Auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij për të gjithë komponentët, konkretisht: Mjedisi i kontrollit; Menaxhimi i riskut; Aktivitetet e kontrollit; Informimi dhe komunikimi; Monitorimi.

Nga auditimi rezultoi se në Bashkinë Klos, Rregullorja e Brendshme e Funksionimit nuk është në koherencë të plotë me strukturën aktuale të Bashkisë; Nuk ka kod etik të veçante, por në rregulloren e brendshme të funksionimit, është përcaktuar në nenin 8, “Etika për punonjësit e Bashkisë Klos dhe kodi i veshjes”; Në Rregulloren e Funksionimit nuk ka procedura mbi trajtimin e rasteve të shkeljeve apo thyerjes së disiplinës nga ana e stafit, për stafin marrëdhëniet e të cilëve rregullohen me kod pune. Gjatë periudhës së auditimit nuk janë kryer vlerësime periodike të stafit, por vetëm vlerësime të stafit të ri pas periudhës së provës. Nuk ka plane trajnimi të miratuar, pavarësisht se janë bërë trajnime kryesisht nga të tretë, për persona të caktuar, nuk ka manuale mbi procedurat për operacionet kryesore, por ato janë përshkruar në rregulloren e brendshme; Nuk ka rregulla të brendshme që garantojnë sigurinë e sistemit IT, veprime jo në përputhje me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ndryshuar, si aktet ligjore e nënligjore dalë në zbatim të tij (*trajtuar më hollësisht në faqet 28-30 të Raportit të Auditimit dhe në aneks A*).

1.1 Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Klos të merren masa për njohjen nga menaxhimi dhe stafi i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit si dhe të komponentëve të tij, për përputhjen e rregullores së brendshme të funksionimit me strukturën organizative; hartimin e kodit etik; hartimin e manualeve mbi procedurat për operacionet kryesore; kryerjen e vlerësimeve periodike të stafit; përcaktimin e rregullave që të garantojnë sigurinë e sistemit IT.

Deri më 31.03.2020.

2- Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Klos është krijuar Njësia e Auditimit të Brendshëm publik, me një specialit, nga 3 që duhet të ketë. Nga mbikëqyrja e veprimtarisë së njësisë Auditimi Publik në Bashkinë (AB) Klos, rezultoi se për periudhën objekt auditimi 2 vjet e 9 muaj respektivisht për vitet 2017, 2018 deri 30.09.2019, u konstatuan mangësitë e mëposhtme:

a. *Organika e Njësisë së AB është vetëm me 1 person, nga 3 që duhet të ketë, pra nuk garantohet kryerja e shërbimit të auditimit.*

b. *Nuk ka plane vjetore auditimi të miratuar nga titullari; Nuk ka rekomandime.*

c. *Edhe një punonjës auditimi që është emëruar, në njësinë e auditit të brendshëm Bashkia Klos, ai, nuk plotëson kushtet e përcaktuara nga ligji nr.114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 11 “Punësimi i audituesit të brendshëm” shkronja b, c dhe ç; pasi drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm nuk është i çertifikuar si “Auditues i brendshëm” dhe nuk ka përvojë pune 5 vjet si auditues i brendshëm ose i jashtëm.*

d. *Nga 12 auditime për vitin 2017, ka realizuar 4 angazhime, kurse për vitin 2018 dhe 9 mujorin 2019 nuk ka realizuar asnjë auditim (angazhime) si dhe nuk ka rekomandime.*

e. *Nuk është hartuar manuali specifik i AB;*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

f. Nuk është hartuar Karta e Auditit të Brendshëm, kërkesë e nenit nr.12, pika c, nenit 14, pika b dhe nenit 24, pika c të ligjit nr.114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e brendshëm në Sektorin publik” dhe shkronja a, neni 64 të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen vendore”;

g. Mungon dokumentacioni i dosjeve të auditimit sipas kërkesave të Manualit të Auditit të Brendshëm, Kapitulli VI, “Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese” edhe ai pak dokumentacion i hartuar për auditimet e kryera është i pa protokolluar.

Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me ligjin nr.114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e brendshëm në Sektorin publik”, Manualit të Auditit të Brendshëm, miratuar me urdhrin e Ministrit Financave nr. 100, datë 25.10.2016 “Për miratimi e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, VKM nr.83, datë 03.02.2016, “Për miratimin e kriterëve për ngritjen e njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik” si dhe detyrat e përcaktuara në rregulloren e brendshme të funksionit, të Bashkisë Klos neni 26, “Detyrat kryesore të Përgjegjësit të Sektorit” (trajtuar më hollësisht në faqet 30-32 të Raportit të Auditimit dhe në aneks A).

2.1 Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Klos të merren masa për plotësimin e organikës dhe vënien në funksion të Njesisë së Auditimit të Brendshëm. Në se nuk mundësohet plotësimi i organikës, me qëllim mos lënien jashtë kontrollit të Njësive Administrative, të negociohet me Bashkinë më të afërme, duke lidhur akt marrëveshje me Njësine e Auditit të Brendshëm të kësaj Bashkie.

Menjëherë.

3. Gjetje nga auditimi: Buxheti për vitin 2017 nuk është përgatitur dhe miratuar brenda datës 25 dhjetor të vitit paraardhës. Buxhetet nuk janë paraqitur për miratim brenda muajit nëntor të vitit buxhetor nga kryetari i njësisë të qeverisjes vendore në Këshillin Bashkiak. Nuk është e qartë nëse buxhetet janë publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike brenda 15 ditëve nga miratimi i tyre. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore nuk ka bërë analizë të plotë të zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor të çdo viti. Përsa i përket pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve të tyre rezultoi se ka diferenca të dukshme midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit,.

Në buxhetet e çdo viti janë planifikuar shpenzimet në vazhdim, por jo në të gjitha rastet është zbatuar radha e financimit.

Për rastet e investimeve nga të ardhurat (të pasqyruar në anekse) çdo prokurim (përveç shpenzimeve operative ose blerjeve të vogla) janë bërë pa pasur fonde në dispozicion, vetëm në bazë të planifikimit.

Përgjithësisht, pagesat e faturave janë bërë gjatë gjithë vitit, por ka pasur raste për investimet e planifikuara për t’u bërë nga të ardhurat, që faturat të paguhen me vonesë, për shkak të mosrealizimit të të ardhurave. (bashkëlidhur aneksit për pagesat me vonesë dhe detyrimeve të prapambetura)

Sa më sipër bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në R.SH”, ndryshuar me ligjin nr. 114/2012, datë 07.12.2012 dhe ligjin nr. 57/2016, datë 2.6.2016), ligjin nr. 130/2016, datë 17.12.2016 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2017”, dhe ligjin nr. 109/2017, datë 30.11.2017 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2018”, me ndryshimet (trajtuar më hollësisht në faqet 35-37 të Raportit të Auditimit dhe në aneks B).

3.1. Rekomandimi: Për vitet në vazhdim, kryetari i Bashkisë Klos të marrë masa për:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

- diskutimin e buxhetit të vitit pasardhës në këshillin bashkiak brenda muajit nëntor të vitit buxhetor dhe për miratimin përfundimtar të tij jo më vonë se data 25 dhjetor. Këto vendime të publikohen rregullisht brenda 15 ditëve në buletin e Njoftimeve Publike dhe zbatimi i buxhetit të analizohet brenda muajit qershor të çdo viti, në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit.
- Bashkia Klos të marrë masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve. Të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin e buxheteve paraardhës duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse.

Menjëherë.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në Bashkinë Klos, rezultoi se nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik nuk është ruajtur plotësisht radha e financimit për procedurat e raportuara si të prapambetura.

Në lidhje me faturat e palikuiduara: **për vitin 2017** nga 14,814,020 lekë të planifikuara janë shpenzuar 14,499,884 lekë dhe **për vitin 2018** nga 39,655,776 lekë të planifikuara janë shpenzuar 38,667,121 lekë.

Shpenzimet operative (602+603+604+606): **për vitin 2017** nga 5,277,961 lekë të planifikuara janë shpenzuar 4,963,825 lekë dhe **për vitin 2018** nga 7,754,569 lekë të planifikuara janë shpenzuar 7,740,569 lekë.

Faturat e pa likuiduara për investime dhe shpenzime të ndryshme, në datën 31.12.2018 paraqiten në vlerën **82,085,867 lekë** të krijuara gjatë viteve para dhe pas reformës krahasuar me gjendjen më 31.12.2017 janë ulur në vlerën 38,072,341 lekë ose krahasuar me gjendjen më 31.12.2016 janë rritur në vlerën 4,145,541 lekë dhe me gjendjen e 31.12.2017 në shumën **10,428,349 lekë**. *Më hollësisht tabela është e bashkëlidhur në aneks B)*

Nga administrata e Bashkisë Klos nuk janë zhvilluar procedura të mjaftueshme për planifikimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

(trajtuar më hollësisht në faqet 37-38 të Raportit të Auditimit dhe në aneks B).

4.1. Rekomandimi: Bashkia Klos (Sektori i Financës), bazuar në UMF nr. 2, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” dhe UMF nr. 1, datë 17.01.2019 “Për buxhetin e vitit 2019”, pikat 106-110, “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, pikat 116-11, 7 “Raportimi i detyrimeve të prapambetura në njësitet e qeverisjes vendore”, të paraqesë në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, të hartojë një grafik duke zbatuar radhën e pagesave sipas kohës së krijimit të tyre për vlerën **82,085,867 lekë**. Nuk duhet të ketë investime të reja pa shlyer detyrimet e prapambetura .

Në mbledhjen më të afërt të Këshillit Bashkiak.

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në Bashkinë Klos, rezultoi se ka mangësi në kryerjen e akt rakordimeve me institucionet përkatëse dhe diferencë të madhe në të ardhurat e planifikuara nga agjentët tatimorë me realizimin, kryesisht me ZVRPP-në për taksën e kalimit të pronësisë dhe DSHTRR-në për taksën vjetore të mjeteve të përdorura. Bashkia Klos nuk ka krijuar baza të plota të dhënash për detyrimet që vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, në bazë të të cilave të bëjë akt-rakordimet. Nga auditimi u konstatua mungesë e marrëdhënieve dhe korrespondencës me institucionet e tjera, shtetërore apo private, me qëllim evidentimin dhe mbledhjen e të ardhurave tatimore dhe tarifore.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

(trajtuar më hollësisht në faqet 41-48 të Raportit të Auditimit dhe në aneks B).

5.1. Rekomandimi: Bashkia Klos, të marrë masa për evidentimin e diferencave të pambledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për gjykitjen e këtyre agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura. Të marrë masa për të krijuar bazat e të dhënave për subjektet, tarifatat apo taksat e të cilave mblidhen nëpërmjet agjentëve tatimorë, të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministri i Financave.

Menjëherë.

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në Bashkinë Klos, u konstatua se për asetet në pronësi të bashkisë, ka mangësi në lidhje me përditësimin e sipërfaqes faktike në dispozicion dhe asaj të regjistruar në ZVRPP (nëse ka) apo në listat e transferimit të pasurive nga KM. Kjo nuk është pasqyruar në inventarin e pasurive të paluajtshme dhe i ka hapur rrugë informalitetit. Gjithashtu, deri në periudhën objekt auditimi, shumë pak nga objektet e dhëna me qira figurojnë të regjistruara në ZVRPP, pra në pak raste Bashkia Klos disponon tituj (certifikata) pronësie për objektet apo tokat e kontraktuara.

Nga auditimi rezultoi se nga kompanitë të cilat bëjnë investime strategjike në territorin e Bashkisë Klos, konkretisht, subjekti “G...”, i cili ndërton me PPP “Rrugën e Arbrit”, përdor territorin e Bashkisë Klos për depozitimin e mbetjeve dhe inerteve të nxjerra gjatë gërmimeve. Nga ana e Bashkisë Klos nuk është marrë asnjë masë për të evidentuar veprimtarinë e këtij subjektit në territorin e saj si dhe për të arkëtuar taksat dhe tarifatat që rrjedhin nga ky aktivitet, Kjo Bashki nuk ka informacion mbi kontratën koncensionare. Ky subjekt nuk është pajisur me NUIS sekondar për aktivitetin që ushtron në territorin e Bashkisë Klos dhe nuk paguan taksat dhe tarifatat vendore.

(trajtuar më hollësisht në faqet 42-44 të Raportit të Auditimit dhe në aneks B).

6.1. Rekomandimi: Bashkia Klos të njihet me kontratën koncensionare dhe në bazë të saj të marrë masa për të verifikuar situatën në terren me subjektet që ushtrojnë veprimtari ndërtimore/minerare, etj. në territorin e saj, t'i autorizojë ose të lidhë kontrata apo aktmarrëveshje për t'i lejuar përdorimin sipas kontratës koncensionare të materialeve/mineraleve të përfituara nga gërmimet ose në të kundërt të fillojë procedurat për vjeljen e rentës minerare, konform ligjit.

Menjëherë.

7. Gjetje nga auditimi:

-Aktivet të cilat janë detajuar me regjistra kontabël (*llogaria 210 “Toka, troje e terrene”, llogaria 211 “Pyje, Plantacione dhe Kullota”*) nuk përmbushin kriteret e paraqitjes së formatit si dhe nuk janë azhurnuar pas bashkimit të njësive administrative duke dhënë një pamje jo të plotë për këto regjistra.

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bashkia Klos për asnjë periudhë raportuese objekt auditimi (2017-2018), nuk ka kërkuar dhe bërë rivlerësim të pasurisë, asetëve dhe aktiveve të transferuara me VKM në kuadër të reformës territoriale me çmimin referues, si dhe nuk janë pasqyruar në aktivet e qëndrueshme të trupëzuara në pasqyrat financiare për secilën periudhë raportuese konkretisht:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

-Ilog.(210)“*Toka, troje, terrene*” vlera kontabël 999,520 lekë e pa ndryshuar.

-Ilog.(211)“*Pyje, kullota, plantacione*” vlera kontabël 0 lekë e pa ndryshuar.

Sektori i Financës dhe kontabilitetit për këto asete nuk disponon regjistra, kartela llogarie dhe dokumentet kontabël, me të dhëna të domosdoshme mbi objektet me qëllim të evidentohen të dhënat e nevojshme si (*viti krijimit të asetit, amortizimi në vite, planimetria dhe projekti objektit ndërtimor, etj.*) në kundërshtim me pikat 31 dhe 74 të udhëzimit 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Nuk është hapur regjistri kontabël i aseteve, në kundërshtim me kapitullin III “*Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre*”, pika 26 dhe 27 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, pasi nëpunësi autorizues nuk ka caktuar nëpunësin zbatues për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit kontabël të të gjithë aktiveve, që zotëron apo ka në administrim Bashkia Klos. Po kështu në kundërshtim me pikën 31/d, të Udhëzimit të mësipërm, nuk është mbajtur regjistri i veçantë për secilën nga pasuritë e dhëna me qira ku të përcaktohet sipërfaqja e objektit në metra katrorë, numri dhe data e kontratës së qirasë, afati i vlefshmërisë së kontratës, afati i qirasë, veprimtaria që kryhet, subjekti përfitues, qiraja mujore dhe arkëtimet sipas muajve të vitit kalendarik

(*trajtuar më hollësisht në faqet 44-46 të Raportit të Auditimit dhe në aneks C*).

1.Për investimin me objekt “*Ndërtim i Bypass-it të Qytetit të Klosit*” kontrata është lidhur në vitin 2017 me vlerën e plotë prej 117,389,925 lekë, edhe pse akti i marrjes në dorëzim është në datën 08.08.2018 nga vlera totale e investimit prej 117,389,925 lekë, vlera prej 71,225,083 lekë është pasqyruar në bilancin e vitit 2017, ndërsa vlera prej 47,104,802 lekë është paraqitur në bilancin e vitit 2018. Nga ana e Sektorit të Financës së Bashkisë Klos e gjithë vlera e investimit prej 117,389,925 lekë duhet të ishte paraqitur në bilancin e vitit 2018, pra në momentin e marrjes në dorëzim të veprës.

Për vlerën 71,225,083 lekë, e cila nuk është pasqyruar në bilancin e vitit 2018, ndërkohë që i gjithë investimi ka përfunduar në vitin 2018, transaksionet dhe ngjarjet nuk janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël.

2.Për investimin me objekt “*Ndërtim i Kanalit Suc*” kontrata është lidhur në vitin 2017 me vlerën e plotë prej 1,391,016 lekë, edhe pse akti i marrjes në dorëzim është në vitin 2018 nga vlera totale e investimit prej 1,391,016 lekë, vlera prej 500,000 lekë është pasqyruar në bilancin e vitit 2017, ndërsa vlera prej 891,016 lekë është paraqitur në bilancin e vitit 2018. Nga ana e Sektorit të Financës së Bashkisë Klos e gjithë vlera e investimit prej 1,391,016 lekë duhet të ishte paraqitur në bilancin e vitit 2018, pra në momentin e marrjes në dorëzim të veprës.

Për vlerën 500,000 lekë, e cila nuk është pasqyruar në bilancin e vitit 2018, ndërkohë që i gjithë investimi ka përfunduar në vitin 2018, transaksionet dhe ngjarjet nuk janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël.

3.Për investimin me objekt “*Ndërtim i aksit Unjate-Mishter*” kontrata është lidhur në vitin 2017 me vlerën e plotë prej 2,153,631 lekë, edhe pse akti i marrjes në dorëzim është në vitin 2018 nga vlera totale e investimit prej 2,153,631 lekë, vlera prej 508,399 lekë është pasqyruar në bilancin e vitit 2017, ndërsa vlera prej 1,645,232 lekë është paraqitur në bilancin e vitit 2018. Nga ana e Sektorit të Financës së Bashkisë Klos e gjithë vlera e investimit prej 2,153,631 lekë duhet të ishte paraqitur në bilancin e vitit 2018, pra në momentin e marrjes në dorëzim të veprës.

Për vlerën 508,399 lekë, e cila nuk është pasqyruar në bilancin e vitit 2018, ndërkohë që i gjithë investimi ka përfunduar në vitin 2018, transaksionet dhe ngjarjet nuk janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël (*trajtuar më hollësisht në faqet 46-47 të Raportit të Auditimit dhe në aneks C*).



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

7.1.Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Klos të merren masa për të azhurnuar regjistrat kontabël me informacion të plotë pas bashkimit me njësitë administrative duke plotësuar kërkesat e formatit të paraqitjes së tyre, të përpilohet lista e aktiveve të identifikuarra për vlerësim dhe inventarizim. Titullari i njësisë publike Bashkia Klos të ngrejë një grup pune me specialist përkatës, për evidentimin e asetëve dhe pasurisë të kaluara me VKM në pronësi të Bashkisë, ndërsa nga Sektori i Financës, të merren masa me qëllim të saktësohet gjendja fizike dhe kontabël e llog.(210); llog.(211) me qëllim pajisjen me dokumentet e nevojshme tekniko-ligjore për të regjistruar secilin objekt në ZRPP në pronësi të Bashkisë Klos, si dhe pasqyrimin me dokumente ligjore të gjendjes së këtyre asetëve.

7.2.Rekomandimi: Sektori i financës në të gjitha regjistrimet kontabël, të veprojë sipas parimit të konstatimit: të gjitha shpenzimet të pasqyrohen në kontabilitet dhe në pasqyrat financiare, atëherë kur ato ndodhin dhe jo kur kryhet pagesa. Raportimi i tyre në pasqyrat financiare të bëhet në atë periudhë kontabël së cilës i përkasin shpenzimet.

Me mbylljen e bilancit të vitit 2019

8. Gjetje nga auditimi: Për aktivitetin e vitit 2018, konstatohet se totali i faturave të pa likuiduara në fund të vitit 2018 në Llog (401-408) “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, paraqitet në vlerën **16,936,547** lekë ndërsa llog (467) “Kreditorë të ndryshëm”, paraqitet në vlerën **65,149,320** lekë. Arsyeja e mos likuidimit të këtyre faturave është nga mos realizimi i të ardhurave, mungesa e lëvrimin të fondeve dhe bllokimit të fondeve nga Ministria e Financave në fund të periudhës ushtrimore. Në testet e kryera bazuar tek të dhënat e sistemit “SIFQ” mbi faturat e likuiduara në periudhën Janar – Gusht 2019, për llogari të vitit 2018 dhe përpara, u konstatua se 1 rast likuidimi në vlerën **4,450,025** lekë paraqet një detyrim të lindur gjatë vitit 2018 dhe duhet të ishte e paraqitur në pasivin e bilancit të vitit 2018 në llog.467 “Kreditorë të ndryshëm”

Llog.467 “Kreditorë të ndryshëm” të Bilancit Kontabël në vitin 2018 të vlerës së detyrimeve të prapambetura të cilat duhet të jenë me vlerë kontabël **69,637,345** lekë dhe jo **65,149,320** lekë. Kjo llogari duhet të rakordohet me llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” me të njëjtën vlerë prej **69,637,345** lekë.

Kjo procedurë mos pasqyrimi në Llog.467 “Kreditorë të ndryshëm” të Bilancit Kontabël të vlerës së detyrimeve të prapambetura të cilat janë me vlerë kontabël **69,637,345** lekë është në kundërshtim me nenin nr.3.3 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore”. Mangësitë e mësipërme (mos regjistrim i faturave kreditore), në fund të periudhës ushtrimore si detyrime që Bashkia Klos ka ndaj subjekteve të ndryshme, bën që pasqyrat financiare të mos paraqesin realitetin e tyre (*trajtuar më hollësisht në faqet 47-49 të Raportit të Auditimit dhe në aneks C*).

8.1.Rekomandimi: Sektori i Financës të paraqesë një material ku të rakordojë me sistemin SIFQ gjendjen e faturave të pa likuiduara në vlerën **69,637,345** lekë, duke ndjekur radhën e pagesave. Gjithashtu, të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave për likuidimin e faturave jashtë kontabilitetit, dhe për çdo rast faturat e pa likuiduara në fund të vitit ushtrimor të bëhet kontabilizimi i tyre, duke i paraqitur si detyrime në fund të periudhës ushtrimore.

Me mbylljen e bilancit të vitit 2019



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Tepricës së Granteve kapitale të brendshme rezultoi tepricë në vlerën **1,817,640** lekë, e cila duhej të mbetej si e tillë vetëm në rastet kur këto grante janë burim për investimet në proces të institucioneve (të papërfunduara ose të pa marra në dorëzim). Nga ana e Bashkisë Klos vlera **1,817,640** lekë paraqet investime të përfunduara në një kohë që nuk është i tillë në kundërshtim me pikën 1.1.2 Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.8 datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore”

(trajtuar më hollësisht në faqet 49-50 të Raportit të Auditimit dhe në aneks C).

9.1.Rekomandimi: Nga Sektorit i Financës të Bashkisë Klos të merren masa për sistemimin në kontabilitet të investimeve të përfunduara në vlerën **1,817,640** lekë duke i debituar te llogaritë e grupit 23 (Investime) të aktiveve afatgjata dhe duke kredituar llog.105 “*Teprica e Granteve kapitale të brendshme*”.

Me mbylljen e bilancit të vitit 2019

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare janë të ndryshme nga vlerat e paraqitura në raportet e monitorimit, konkretisht:

- “*Shpenzimet korrente*” sipas bilancit paraqiten në vlerën **399,909 mijë lekë** kurse sipas raportit të monitorimit vlera e tyre është **400,317 mijë lekë** me diferencë **-408 mijë lekë**.

- Llog. 600 “*Paga e shpërblime të tjera personeli*” në formatin nr. 3/1 “Shpenzime të ushtrimit” paraqitet në vlerën **99,102 lekë** kurse në raportin e monitorimit vlera e kësaj llogarie është **110,514 mijë lekë** me një diferencë prej **-1,412 mijë lekë**.

- Llog. 601 “*Kontribute Sigurime Shoqërore e shëndetësore*” në formatin nr. 3/1 “Shpenzime të ushtrimit” paraqitet në vlerën **17,907 mijë lekë** kurse në raportin e monitorimit 2018 vlera e kësaj llogarie është **17,867 mijë lekë** me një diferencë prej **40 mijë lekë**.

- Llog. 602 “*Mallra dhe shërbime të tjera*” në formatin nr. 3/1 “Shpenzime të ushtrimit” paraqitet në vlerën **55,265 mijë lekë** kurse në raportin e monitorimit 2018 vlera e kësaj llogarie është **65,400 mijë lekë** më pak prej **-10,135 mijë lekë**.

Raportet e monitorimit të shpenzimeve për vitin 2018, që janë paraqitur në Ministrinë e Financave, ndër të tjera edhe për programin “Planifikim, menaxhim, administrim” të cilat nuk janë të plotësuar me një informacionin më të plotë me shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e PBA, buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel programi dhe artikulli, lidhur me ndryshimet e planit të produkteve, si në sasi dhe në vlerë në përputhje me Udhëzimet e Ministrisë së Financave për zbatimin e buxhetit të shtetit. Mungojnë argumentet e plota në lidhje me mosrealizimin e produkteve dhe masat që parashikohen në të ardhmen për realizimin e tyre. Performanca e produkteve “Planifikim, menaxhim, administrim” nuk është e paraqitur e lidhur me realizimin e objektivave dhe politikës së programit ku të shpjegohej cilat ishin objektivat sipas PBA, politikat e çdo programi si dhe sa janë realizuar këto objektiva. Të dhënat faktike të raportuara nga Bashkia Klos nuk janë në përputhje me shpenzimet e ushtrimit të paraqitura në formatin nr. 4 “Shpenzimet e ushtrimit” *(trajtuar më hollësisht në faqet 50-51 të Raportit të Auditimit dhe në aneks C).*

10.1.Rekomandimi: Nga ana e Sektorit të Financës të Bashkisë Klos të merren masa për të bërë rakordimin dhe unifikimin e vlerave të paraqitura në pasqyrat financiare me vlerat e paraqitura në raportin e monitorimit të shpenzimeve. Raporti i Monitorimit për zbatimin e buxhetit, të përmbajë një informacion të plotë me shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e PBA, e buxhetit, nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel programi dhe artikulli, lidhur me ndryshimet e planit të produkteve, si në sasi dhe në vlerë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

Me mbylljen e bilancit të vitit 2019

11. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Klos, nga auditimi i aktiveve afatshkurtra dhe aktiveve afatgjata, llogaritë: Llogaria 212 “Ndërtesa dhe Konstruksiione”, 213 “Rrugë, rrjete dhe vepra ujore” dhe 31 “Materiale”, rezultoi se për 9 mujorin 2019, janë zhvilluar 9 blerje me vlerë të vogël apo të lartë, të cilat janë artikuj ndërtimi, që do të vihen në objekt nga ana e vetë Bashkisë (me punonjësit e Bashkisë). Për aktivet sa më sipër, të bëra hyrje janë hartuar akt marrjet në dorëzim nga komisionet përkatëse të marrjes në dorëzim, të ngritura me urdhër të Titullarit të Bashkisë. Janë bërë hyrje në magazinë materiale ndërtimi në vlerën 13,460,245 lekë dhe janë bërë dalje materiale në vlerën 2,275,287 lekë.

Për periudhën 9 mujori 2019, gjendja e kartelave të magazinës për to nuk rakordon me gjendjen fizike të materialeve të bëra hyrje, në shumën 11,184,958 lekë.

Gjithashtu për këtë mos rakordim u konstatua se vlera prej 10,427,467 lekë është bërë hyrje, nuk është gjendje në magazinë, nuk është bërë dalje dhe nuk është likuiduar nga Bashkia Klos. Ndërsa shuma prej 2,665,812 lekë, është bërë hyrje në magazinë, nuk është bërë dalje, nuk është gjendje fizike dhe është likuiduar. Në përdorimin e këtyre materialeve nuk ka urdhër dorëzimi, fletëkërkesa, plan shpërndarje, nuk ka fletë dalje provizore, nuk ka preventiva dhe situacione për punën e kryer. Gjithashtu nisur nga fakti se këto janë materiale ndërtimi, të cilat nuk mund të magazinohen, nuk janë bërë dalje direkt sipas objekteve (pa kaluar në magazinë).

Në lidhje me këto materiale nga auditimi rezultoi se ekzistojnë akt konstatime të mbajtura nga Sektori i Shërbimeve, në NJA Suç, Gurrë, Xibër dhe për qytetin Klos.

Këto konfirmojnë tërheqjen përkatëse nga magazina dhe vënien në objekt të tyre. Autorizimet janë firmosur nga personi i autorizuar dhe nga përfaqësues të Sektorit të Shërbimeve, për: NJA Suç në 21 raste, NJA Gurrë në 26 raste, Klos në 22 raste, NJA Xibër në 31 raste.

Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave, nr.30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, dalë në zbatim të nenit 6, germa “e” të ligjit nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, kapitulli “**Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve**”, pikat **38, 39, 40, 41** (trajtuar më hollësisht në faqet 51-54 të Raportit të Auditimit dhe në aneks C/1).

11.1 Rekomandimi: Nga ana Bashkisë Klos të merren masa për ngritjen e një grupi pune, të përbërë nga Drejtoria e Urbanistikës, Drejtoria e Shërbimeve, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Sektori i Auditit të Brendshëm, me qëllim të verifikimit të materialeve të vëna në objekte (të cilësuar nëpër aktkonstatimet përkatëse), rakordimit të tyre nëpërmjet hartimit të situacioneve, deri në kryerjen e veprimeve me magazinën dhe kontabilitetin.

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve në mënyrë të përmblodhur zbatimi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

a . Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 14 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 14 masa, nga të pranuarat janë zbatuar 6 masa dhe janë në proces zbatimi 6 masa organizative dhe ka 2 masa organizative të pa zbatuara.

b.Për shpërblim dëmi janë rekomanduar 18 masa me vlerë 83,767,657 lekë, deri me datë 30.09.2019, janë arkëtuar 2,403,429 leke, ndërsa shuma prej 81,419,908 lekë nuk është



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

arkëtuar dhe është kontabilizuar vlera prej 75,915,662 lekë. (trajtuar më hollësisht në faqet 55-56 të Raportit të Auditimit dhe në aneks E).

12.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Klos të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara të KLSH në auditimin e mëparshëm, si masa shpërblim dëmi dhe masa organizative.

Menjëherë

B . MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DUKE RRITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në Bashkinë Klos, rezultoi se ka diferenca të konsiderueshme në arkëtimin e detyrimeve tatimore për bizneset dhe familjarët, në lidhje me taksat dhe tarifatat vendore dhe për llogaritjen e kontabilizimit të kamatëvonesave në vlerën **43,105,656 lekë**, respektivisht:

-detyrimet për taksën e tokës në vlerën..... **5,477,706 lekë**,

-detyrimet për taksat dhe tarifatat të familjarëve në vlerën.....**13,766,523 lekë**,

-vlerën totale të debisë për bizneset (detyrim+kamatë) është ...**23,861,427 lekë**.

Të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Klos, nga këto janë kontabilizuar 24,693,324 lekë dhe pa kontabilizuar shuma 12,934,626 lekë.

Nga Sektori i të Ardhurave të Bashkisë Klos, nuk janë marrë masa për arkëtimin e detyrimeve debitorë, duke ribërë njoftim vlerësimet tatimore vendore për të gjithë subjektet debitorë. Nuk janë zbatuar masa shtrënguese, me qëllim arkëtimin e detyrimeve tatimore.

Sektori i të Ardhurave Vendore nuk ka dërguar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, asnjë kërkesë për të vendosur Barrë Sigurie mbi titujt e pronësisë për mjetet dhe pasuritë e paluajtshme, sipas nenit 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

(trajtuar më hollësisht në faqet 37-38 të Raportit të Auditimit dhe në aneks B).

1.1 Rekomandimi: Bashkia Klos, nëpërmjet Sektorit të Tatim Taksave e Tarifave të marrë masa, për arkëtimin e detyrimeve tatimore, në shumë gjithsejt prej **43,105,656 lekë**, respektivisht:

-detyrimet për taksën e tokës në vlerën..... **5,477,706 lekë**,

-detyrimet për taksat dhe tarifatat të familjarëve në vlerën.....**13,766,523 lekë**,

-vlerën totale të debisë për bizneset (detyrim+kamatë) është ...**23,861,427 lekë**.

Sa sipër, bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nga Drejtoria e Taksave të nxirren njoftim vlerësimet tatimore dhe për arkëtimin e detyrimeve në vlerën **43,105,656 lekë**, të ndiqen **rrugët e mëposhtme:**

a) Tu ridërgohen bankave urdhrat e bllokimit të llogarive, bazuar në nenin 90 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (Në rast mos kryerjes të urdhër bllokimeve prej bankave të njoftohet Guvernatori i Bankës Shqipërisë).

b) Ti ri dërgohen Drejtorisë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

c) **Për subjektet të cilët nuk** kanë paguar detyrimet tatimore në afat, ndaj tyre të fillojë llogaritja e gjobës në masën 0,06% të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, por jo më tepër se 365 ditë (gjobë), bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, me ligjin nr.164/2014, datë 15.12.2014.

ç) **Në se edhe pas njoftimeve** zyrtare Bizneset nuk janë paguar detyrimet edhe pas masave të mesiperme Bashkia të zbatonte ndaj tyre dhenien e masave administrative, nga ana e Bashkisë (Drejtoria e të Ardhurave dhe Drejtoria Juridike) të marrin masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal bazuar në Kodin Penal të Republikën e Shqipërisë miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181,-*Mospagimi i taksave dhe tatimeve.*

d) **Drejtoria e Taksave** në Bashkinë Klos të listojë në mënyrë elektronike abonentët familjarë dhe të merren masa për arkëtimin e taksave të familjarëve, taksës së tokës nga fermerët e 2 Njësive Administrative. Në zbatim të udhëzimit plotësues të Ministrisë Financave nr. 2, datë 19.01.2018 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018”, pika 76, sipas të dhënave që disponon Gjendja Civile, të njoftohen tatimpaguesit familjarë dhe bizneset me Njoftim vlerësimi tatimor edhe në median lokale (të Bashkisë) për të paguar detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak, nëpërmjet dërgimit të njoftim vlerësimit me anë të zyrës postare, për të gjitha llojet dhe shumën e taksave të papaguara, si taksën e tokës, banesave dhe tarifave etj .

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të tarifave vendore për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre në Bashkinë Klos, u konstatua se ka mangësi në plotësimin e të dhënave të këtyre subjekteve në përgjithësi dhe debitorëve në veçanti, si p.sh., në krijimin e një regjistri të posaçëm për këto lloj subjektësh, në evidentimin e subjekteve që e ushtrojnë këtë lloj aktiviteti dhe në mbledhjen e detyrimeve specifike për këto kategori biznesi. Nga auditimi i kësaj kategorie të bizneseve, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua se nga ish-komunat dhe ish-bashkia, si para konsolidimit, ashtu edhe pas konsolidimit, vazhdimisht është aplikuar në mënyrë të gabuar tarifa për pajisjen me leje tregtimi për karburantet, në VKM-në nr. 344, datë 19.04.2017, ndryshuar me VKM-në Nr. 970, datë 2.12.2015, pika 9 dhe 10. Sipas këtyre detyrimeve ligjore, të gjitha subjekteve që ju ka mbaruar afati 5 vjeçar i autorizimit pas datës të hyrjes në fuqi të VKM-së nr. 970, datë 2.12.2015, për rinovimin e licencës duhet të paguajnë si më sipër. Në shumicën e rasteve tarifa e pajisjes me autorizim për tregtimin e hidrokarbureve është llogaritur gabim. Kjo përbën të ardhur të munguar për Buxhetin e Bashkisë Klos, në vlerën **4,300,000 lekë.**

(trajtuar më hollësisht në faqet 42-44 të Raportit të Auditimit dhe në aneks B).

2.1. Rekomandimi: Bashkia Klos të marrë masa për të kontabilizuar detyrimin dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **4,300,000 lekë**, (sipas detajimeve në anekset bashkëlidhur), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit ndaj debitorëve. Gjithashtu, të verifikojë nëse ka subjekte të tjera të cilat në QKB figurojnë aktivë dhe me objekt aktiviteti tregtinë e karburanteve apo lëndëve djegëse për popullatën të cilat zhvillojnë këtë lloj aktiviteti dhe të liqenohen apo të pezullohen, sipas rastit.

Menjëherë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

C. MASA DISIPLINORE

c.1-Për punonjësit të cilët janë pjesë e shërbimit civil:

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të nenit 58, “Ilojet e masave disiplinore” të ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2017 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, datë 18.12.2014, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe neni 64 shkronjën g, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Klos, që ti kërkojë Komisionit disiplinor të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore “**vërejtje**”, neni 58 germa (a), për **1 punonjës** si më poshtë:

1- V.K., me detyrë përgjegjës i Sektorit të Auditimit të Brendshëm, Bashkia Klos.

- a. *Nuk ka plane vjetore auditimi të miratuar nga titullari;*
- b. *Nga 12 auditime për vitin 2017, ka realizuar 4 angazhime, kurse për vitin 2018 dhe 9 mujorin 2019 nuk ka realizuar asnjë auditim (angazhime).*
- c. *Nuk është hartuar manuali specifik i AB;*
- d. *Nuk është hartuar Karta e Auditit të Brendshëm, kërkesë e nenit nr.12, pika c, neni 14, pika b dhe neni 24, pika c të ligjit nr.114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e brendshëm në Sektorin publik” dhe shkronja a, neni 64 të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen vendore”;*
- e. *Mungon dokumentacioni i dosjeve të auditimit sipas kërkesave të Manualit të Auditit të Brendshëm, Kapitulli VI, “Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese” edhe ai pak dokumentacion i hartuar për auditimet e kryera është i pa protokolluar.*

c/II. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës:

Mbështetur në neni 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe kontratës individuale të punës, neni 11, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë** fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore; “**Vërejtje me paralajmërim**”, neni 9 shkronja “c”, e kontratës individuale për 1 punonjës sa më poshtë:

- **S.A.**, me detyrë magazinier, në Bashkinë Klos.

Pasi për periudhën 9 mujori 2019, gjendja e kartelave të magazinës nuk rakordon me gjendjen fizike të materialeve të bëra hyrje, (pavarësisht se janë materiale ndërtimi që nuk mund të magazinohen) në shumën **11,184,958 lekë**.

Në përdorimin e këtyre materialeve nuk ka urdhër dorëzimi, fletëkërkesa, plan shpërndarje, nuk ka fletë dalje provizore, nuk ka preventiva dhe situacione për punën e kryer. Në lidhje me këto materiale nga auditimi rezultoi se ekzistojnë akt konstatime për përdorimin e tyre të mbajtura nga Sektori i Shërbimeve, në NJA Suç, Gurrë, Xibër dhe për qytetin Klos. Këto akt konstatime konfirmojnë tërheqjen përkatëse nga magazina dhe vënien në objekt të tyre. Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave, nr.30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, dalë në zbatim të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
PROJEKT RAPORT AUDITIMI PËR “AUDITIMIN FINANCIAR” TË
USHTRUAR NË BASHKINË KLOS.

nenit 6, germa “e” të ligjit nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, kapitulli “**Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve**”, pikat **38, 39, 40, 41**.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT